

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XIX, nr. 5841
E mërkurë, 31 korrik 2019
çmimi 0.40 €

Marrëveshja
Kosovë - Zvicër për
pensionet hyn në fuqi
më 1 shtator FAQE 5



Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com



facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR **ABBRUCH** GMBH
www.awr-abbruch.de

OPINION

'BANANA
REPUBLICAT
BALLKANIKE' F. 8



Prof. Dr. Blerim REKA

AKTUALE

CERTIFIKOHEN 119 OFICERË
KORREKTUES TË SHËRBIMIT
KORREKTUES TË KOSOVËS F. 7

FILLOJNË DËGJIMET
BUXHETORE NË SKENDERAJ F. 6

EKONOMI

NAFTËTARËT E KUNDËRSHTOJNË
PASTRIMIN E REZERVUARËVE
ÇDO TRE VJET F. 9

KULTURË

NË NJËVJETORIN E VDEKJES,
BEKIM LUMI VLERËSOHET
PËR VEPRAT E TIJ NË ARTË F. 5



SPORT

E PREMTJA E MADHE E
FERIZAJT, BYLBYL SOKOLI
NUK E PRET F. 18

FLET PËR "EPOKËN E RE", POLITOLOGU RAMUSH TAHIRI FAQE 4-5

Në këto zgjedhje partitë ta masin fuqinë veç e veç

- Të thirret seancë e jashtëzakonshme
për shpërbërjen e Kuvendit

Politologu Ramush Tahiri ka thënë se do të dëshironte që në zgjedhjet e parakohshme parlamentare partitë politike ta masin fuqinë e votës veç e veç pa bërë koalicione parazgjedhore. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se rruga më e shkurtër për t'i shpallur zgjedhjet e reja është shpërbërja e Kuvendit. Tahiri ka thënë se kjo gjë mund të bëhet duke thirrur seancë të jashtëzakonshme. Ai ka pohuar se në situatën në të cilën gjendet Kosova zgjedhjet e parakohshme janë zgjidhje. Duke folur për ftesën e presidentit për t'i thirrur në konsulta partitë politike, Tahiri ka thënë se Thaçi do të duhej që t'i thërriste në një takim të përbashkët të gjitha partitë në mënyrë që të mos zgjatet procedura për mbajtjen e zgjedhjeve të reja



PRESIDENTI HASHIM THAÇI KA NISUR KONSULTIMET ME PARTITË POLITIKE PAS DORËHEQJES SË RAMUSH HARADINAJT NGA POSTI I KRYEMINISTRIT



Presidenti Thaçi: Sa më shpejt të kemi një qeveri funksionale

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka filluar konsultimet me partitë politike në lidhje me zhvillimet pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj. Thaçi të martën ka nisur

takimet me dy parti të komuniteteve joshumicë që përfaqësojnë komunitetin turk dhe atë boshnjak në Kuvendin e Kosovës. Presidenti Thaçi pas këtij takimi ka theksuar se tani

shtrohet nevoja për hapa konkretë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës për të pasur në vend sa më shpejt një qeveri funksionale dhe efektive FAQE 3

Telekomi i Kosovës
shkëput kontratën me
'Z-Mobile' FAQE 9



RENOVA
PUTZ
Maqedoni
Xhepcisht-Tetovë
Curëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI

www.kolegijbiznesi.com
info@kolegijbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj. Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

Meta: Pa zgjedhje normale nuk ka integrim në BE

TRANË, 30 KORRIK - Presidenti Ilir Meta në një konferencë me gazetarë ka folur për procesin e integritimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian. Ai deklaroi se qëndrimi i tij gjatë gjithë karrierës në politikë ka qenë i qartë për integrimin e vendit në Bashkimin Evropian. Duke u ndalur te pritshmëritë e vendeve të BE-së në muajin tetor për negociatat, presidenti tha se pa zgjedhje normale më 13 tetor Shqipëria nuk mund ta marrë çeljen e negociatave. "Për çështjen e integritimit, siç ka shqiptarë që mendojnë ndryshe, ka dhe ndërkombëtarë që mendojnë ndryshe. Unë e kam thënë disa herë dhe po jua them prapë dhe

do t'jua them prapë. Nuk realizohet integrimi në BE as me lobingje dhe as me qoka. Janë disa standarde të Kopenhagës që nuk kanë ndryshuar dhe nuk do të ndryshojnë, sepse nëse ndryshojnë ato, nuk ka më Evropë", tha kreu i shtetit.

Presidenti Ilir Meta gjatë konferencës me gazetarë ka komentuar vendimin e mazhorancës për ta dërguar kërkesën për shkarkimin e tij në Komisionin e Venecias. I pyetur nga gazetarët nëse ka frikë nga përgjigja e një institucioni ndërkombëtar, Meta është shprehur me bindje se as nga Komisioni i Venecias dhe as nga Bialja e Venecias nuk ka frikë.

Ndër të tjera, ai ka sjellë në vëmendje gjyqin e qeverisë me Francesco Bechettin, duke thënë se do të jetë një kosto e madhe për shqiptarët nëse dështon Shqipëria. "As nga Komisioni i Venecias, as nga Bialja e Venecias, të cilën ua kam mbajtur sekret, por e vizitova tani që mora 'Luanin e Artë' dhe është diçka frymëzuese. Nuk kam hallin e Venecias, por që të dalë mbi ujë gjyqi i Bechettit dhe që qeveria ta fitojë, se është faturë e madhe për shqiptarët, nëse ka dështim dhe të shikojë të hapë sytë për gjithë proceset e tjera që janë në gjykatat evropiane, sepse janë kosto të mëdha për të gjithë shqiptarët", tha Meta.



Serbia e ka dorëzuar kërkesën për ekstradimin e Tomor Morinës

Pasi është arrestuar nga policia maqedonase, në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga INTERPOL-i, Serbia e ka paraqitur pranë autoriteteve të Maqedonisë së Veriut kërkesën për ekstradimin e ish-pjesëtarit të UÇK-së, Tomor Morina

SHKUP, 30 KORRIK - Serbia e ka paraqitur pranë autoriteteve të Maqedonisë së Veriut kërkesën për ekstradimin e ish-pjesëtarit të UÇK-së, Tomor Morina, i arrestuar nga Policia maqedonase, në bazë të një fletarrestimi të lëshuar nga INTERPOL-i, me kërkesë të Serbisë. Detaje të tjera mbi kërkesën e palës serbe nuk jepen, ndërkohë që lidhur me këtë kërkesë duhet të vendosë Ministria e Drejtësisë në Shkup.

Këshilli i Gjykatës Penale për krim të organizuar në Shkup ka refuzuar të premtën kërkesën e palës mbrojtëse për lirimin nga paraburgimi 30-ditor të Tomor Morinës.

Avokati i Morinës, Naser Raufi, për "Radion Evropa e Lirë" ka shprehur besimin për një epilog pozitiv në procedimin e mëtejshëm lidhur me këtë rast.

"Po punohet shpejt në këtë rast dhe pasi Beogradi ta dërgojë dokumentacionin, unë do t'i shoh së bashku me Tomorin, por unë nuk besoj se do të dërgojnë diçka mbi pretendimet e tyre. Në fund vendos ministri i Drejtësisë, pra qeveria. Mendoj se punët janë mirë", ka deklaruar avokati Raufi.

Zëvendëskryeministri për çështje evropiane i Maqedonisë së Veriut, Bujar Osmani, e ka quajtur "veprim të patolerueshëm" arrestimin e Morinës duke kërkuar nga institucionet lirimin e menjëhershëm të tij. "Morina duhet të lirohet. Është vërtet e tmerrshme kjo që ka ndodhur, sepse kjo ndikon në marrëdhëniet midis Maqedonisë së Veriut dhe Kosovës. Kërkesa e Serbisë vlen për qytetarët e saj, ndërsa ne qytetarët e Kosovës i



kemi pranuar si qytetarë të Kosovës", ka deklaruar Osmani. Kryeministri Zoran Zaev ka thënë se në këtë rast do të veprojë në përputhje të plotë

me ligjet vendore dhe ndërkombëtare.

Arrestimi i Tomor Morinës ka nxitur reagime të shumta në Prishtinë e cila ka kërkuar nga

Shkupi lirimin e menjëhershëm të Morinës si dhe t'i hedhë poshtë urdhrat politike për arreste të lëshuara nga Beogradi.

Basha: T'i shporrim me çdo mjet dhe formë hajdutët e bashkive

TRANË, 30 KORRIK - Kreu i Partisë Demokratike, Lulzim Basha, ka qëndruar të martën në Devoll në mbështetje të qytetarëve që kundërshtojnë marrjen e bashkisë nga Partia Socialiste. Basha u shpreh se sot pushteti vendor është uzurpuar nga një pakicë kriminale. Kreu i PD-së tha se ndaj uzurpuesve qytetarët do të sillen njëjloj si ndaj grabitësve që hyjnë në banesë. "Mund të futen si hajdutë, por nuk mund të qev-

erisin asnjë ditë", deklaroi Basha. Me tone të ashpra Lulzim Basha deklaroi se pakica kriminale që qeveris vendin nuk do të mund t'i marrë të gjitha pushtetet. Ai deklaroi se qytetarët do të përdorin çdo formë dhe çdo mjet për të mos lejuar pushtimin e institucioneve nga një bandë kriminale. "Shumë shpejt do ta shporrim këtë pakicë nga Devolli dhe gjithë Shqipëria", tha lideri i Partisë Demokratike.

Prej dy ditësh në bashkinë e Devollit kandidati i PS-së në zgjedhjet monopartiake të 30 qershorit është marrë me ndihmën e policisë bashkiake. Opozitarët e Devollit kanë zhvilluar disa protesta para bashkisë dhe nuk njohin rezultatin e votimeve. Ndërkohë të martën e njëjta situatë tensioni ka qenë dhe në Kavajë, ku qytetarët nuk kanë lejuar marrjen e detyrës nga kandidati i Partisë Socialiste.



Presidenti Hashim Thaçi ka nisur konsultimet me partitë politike pas dorëheqjes së Ramush Haradinajt nga posti i kryeministrit

Presidenti Thaçi: Sa më shpejt të kemi një qeveri funksionale



Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, i ka filluar konsultimet me partitë politike në lidhje me zhvillimet pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj. Thaçi të martën ka nisur takimet me dy parti të komuniteteve joshumicë që përfaqësojnë komunitetin turk dhe atë boshnjak në Kuvendin e Kosovës. Presidenti Thaçi pas këtij takimi ka theksuar se tani shtrohet nevoja për hapa konkretë në përputhje me Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës për të pasur në vend sa më shpejt një qeveri funksionale dhe efektive

jë edhe kryetaren e KQZ-së, Valdete Daka, për t'i vazhduar konsultat për hapat e mëtejshëm në këto rrethana të reja. Më 19 korrik Ramush Haradinaj dha dorëheqje nga pozita e kryeministrit, pasi ishte ftuar nga Prokuroria Speciale e Dhomave

të Veçanta në Hagë për t'u intervistuar në cilësinë e të dyshuarit për krime lufte. Që nga ai çast spektri politik i ka bërë thirrje presidentit Thaçi të ndërmarrë veprime për tejkalimin e gjendjes qoftë përmes formimit të qeverisë së re apo shpalljes së

zgjedhjeve të reja.

Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, më pas njoftoi se do t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e nevojshme në pajtim me kompetencat e përcaktuara në Kushtetutën e Republikës së Kosovës.

Haradinaj mban takim me Limajn e Pacollin, mungon Veseli

Kryeministri në dorëheqje, Ramush Haradinaj, ka mbajtur të martën një takim me liderët e koalicionit qeverisës, në të cilin takim ka munguar kryetari i PDK-së, Kadri Veseli. Ndërkaq të pranishëm kanë qenë Fatmir Limaj dhe Behgjet Pacolli. "Është një bindje e gjithë neve që zgjedhjet duhet të ndodhin në kohë. Ka bazë të mirë që partitë politike me pajtim të plotë ta shpërbëjnë Kuvendin dhe të mos humbet kohë. Pra, të ketë koordinim të

veprimeve në nivel të grupeve parlamentare dhe që gjithë së bashku të votojnë një mocion për shpërbërjen e Kuvendit", ka thënë Haradinaj pas këtij takimi. Ai ka thënë se, pavarësisht se Veseli nuk ka qenë pjesë e këtij takimi, ka dëgjuar deklaratimet e tij që vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja. "Tani është kohë fushate dhe shihet se fushata ka filluar. Kam dëgjuar deklaratimet e Kadri Veselit që është për zgjedhje", ka thënë Haradinaj.

Kryetari i Nismës Socialdemokrate, Fatmir Limaj, ka deklaruar se ky ishte një takim normal konsultativ dhe se të gjithë janë të vetëdijshëm se vendi duhet të shkojë në zgjedhje të reja. "Janë takime normale konsultative. E pimë nga një kafe më herët me kolegë. Biseduam për zhvillimet se si të ecim përpara. Besoj se është e qartë që vendi është në prag të zgjedhjeve dhe duhet sa më shpejt t'i jepet epilog kësaj çështje", ka thënë Limaj.

EPOKA E RE **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 KORRIK - Presidenti i Republikës së Kosovës, Hashim Thaçi, të martën ka takuar përfaqësuesit e KDTP-së dhe ata të VAKAT-it nga grupi parlamentar 6+, ministrin Mahir Jaghillar dhe deputetët Duda Balje dhe Bahrim Sabani, me të cilët ka biseduar për zhvillimet politike pas dorëheqjes së kryeministrit, pasi që Republika e Kosovës ka mbetur pa qeveri. Presidenti Thaçi u shpreh se tani shtrohet nevoja për hapa konkretë në përputhje me

Kushtetutën dhe ligjet e Kosovës për të pasur në vend sa më shpejt një qeveri funksionale dhe efektive. Ai ka thënë se kjo qeveri duhet ta reflektojë vullnetin e partive politike për një solucion të ri qeverisës apo atë të një procesi elektorale të ri dhe të bëjë të mundur që Kosova të bëhet sa më shpejt me qeveri. Presidenti ka theksuar se takimet me partitë e tjera politike do të vazhdojnë në ditët e ardhshme, varësisht nga agjenda dhe zhvillimet brenda partive politike përkatëse. Presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, sot (e mërkurë) do ta tako-

Marrëveshja Kosovë - Zvicër për pensionet hyn në fuqi më 1 shtator

PRISHTINË, 30 KORRIK (ER) - Zyra Federale e Zvicrës për Sigurimet Shoqërore (BVS) ka konfirmuar hyrjen në fuqi të marrëveshjes ndërshtetërore mbi sigurimet shoqërore Zvicër - Kosovë duke

filluar nga 1 shtator 2019. Shtetasit e Kosovës që nga data 1 shtator mund t'i marrin pensionet e moshës dhe trashëgimisë (AHV) si dhe ato të invaliditetit (IV) pa qenë të

obliguar të jetojnë në Zvicër. Këtë marrëveshje të dyanshme Kosovë - Zvicër para dy muajsh e ka ratifikuar edhe Parlamenti i Konfederatës Helvetike. Marrëveshja Kosovë - Zvicër për

nga përmbajtja është e ngjashme me ato të nënshkruara nga konfederata zvicerane me të gjitha vendet e tjera dhe mbështetet në standarde ndërkombëtare.





Flet për "Epokën e re", politologu Ramush Tahiri

NË KËTO ZGJEDHJE PARTITË TA MASIN FUQINË VEÇ E VEÇ

- Të thirret seancë e jashtëzakonshme për shpërbërjen e Kuvendit

Politologu Ramush Tahiri ka thënë se do të dëshironte që në zgjedhjet e parakohshme parlamentare partitë politike ta masin fuqinë e votës veç e veç pa bërë koalicione parazgjedhore. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", ai ka theksuar se rruga më e shkurtër për t'i shpallur zgjedhjet e reja është shpërbërja e Kuvendit. Tahiri ka thënë se kjo gjë mund të bëhet duke thirrur seancë të jashtëzakonshme. Ai ka pohuar se në situatën në të cilën gjendet Kosova zgjedhjet e parakohshme janë zgjidhje. Duke folur për ftesën e presidentit për t'i thirrur në konsulta partitë politike, Tahiri ka thënë se Thaçi do të duhej që t'i thërriste në një takim të përbashkët të gjitha partitë në mënyrë që të mos zgjatet procedura për mbajtjen e zgjedhjeve të reja

EPOKA E RE

Muhamet KOCI

PRISHTINË, 30 KORRIK - Politologu Ramush Tahiri ka thënë se në situatën në të cilën gjendet Kosova zgjedhjet e parakohshme janë zgjidhje pasi nuk ka zgjidhje tjetër. Ai ka thënë se partitë politike në këto zgjedhje do të duhej që ta masin forcën veç e veç, tek pas zgjedhjeve të bëjnë koalicione për formimin e institucioneve të reja. Në këtë intervistë dhënë për gazetën "Epoka e re", Tahiri ka theksuar se rruga më e shkurtër për t'i shpallur zgjedhjet e reja është shpërbërja e Kuvendit. "Procedura më e shkurtër të cilën e njeh ligji dhe e cila i shkurton të gjitha procedurat e tjera është të thirret seancë e jashtëzakonshme dhe të shpërbëhet Kuvendi, të cilën gjë e premtoi të hënën edhe Kadri Veseli", ka thënë Tahiri. Ai ka thënë se subjektet politike të PAN-it do të duhej që t'i

dërgonin letër zyrtare presidentit Hashim Thaçi pas dorëheqjes së kryeministrit në mënyrë që t'i tregonin se nuk duan të propozojnë kandidat të ri për kryeministër ashtu si e parashihnin nën 95 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës, por që duan të shkojnë në zgjedhje të parakohshme.

Duke folur për ftesën e presidentit për t'i thirrur në konsulta partitë politike, Tahiri ka thënë se Thaçi do të duhej që t'i thërriste në një takim të përbashkët të gjitha partitë në mënyrë që të mos zgjatet procedura për mbajtjen e zgjedhjeve të reja. "Nëse dëshiron që çdo ditë ta thërras nga një parti atëherë ai e zgjat procedurën që, edhe po të dojë t'i caktojë zgjedhjet, nuk mundet para muajit tetor", ka thënë analisti Tahiri.

"Epoka e re": Z. Tahiri, pas dorëheqjes së kryeministrit Ramush Haradinaj të gjitha partitë politike kanë shprehur

gatishmëri për zgjedhje të reja, por ende nuk kemi parë ndonjë veprim që na çon drejt zgjedhjeve. Si duhet të ecet tutje?

Tahiri: Kosova duhet ta respektojë Kushtetutën, ligjet dhe procedurat e parapara. Të gjitha partitë kanë deklaruar se duan të shkojnë në zgjedhje, por asnjë parti nuk ka ndërmarrë asnjë iniciativë për ta çuar vendin në zgjedhje. Zyrtarisht nuk ka procedurë që të shkojë vendi në zgjedhje sepse z. Haradinaj në emër të partisë së tij nuk i ka dorëzuar kërkesë me shkrim presidentit se vendi duhet të shkojë në zgjedhje. Së dyti, asnjë parti politike, as nga PAN-i dhe as nga partitë e tjera, nuk i kanë dorëzuar letër zyrtare presidentit përmes së cilës tregohet se nuk janë të interesuara për asgjë tjetër, përveç mbajtjes së zgjedhjeve të reja. Subjektet politike të PAN-it do të duhej t'i dërgonin letër zyrtare presidentit, pra këtë do të duhej ta bënte z. Veseli në emër të këtij të



Kadri Veseli. Pra, Veseli si kryetar i Kuvendit të Kosovës mund t'i thërrasë në takim të gjitha partitë parlamentare dhe këtë mund ta bëjë brenda pesë ditësh. Ligji parashih që zgjedhjet e parakohshme nuk mund të mbahen më herët se 30 ditë dhe më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit. Nëse deputetët i bëjnë dy vjet mandat më 7 gusht, atëherë Kuvendi nuk do të shpërndahet deri me këtë datë. Me ligj deputetët nuk duan ta shpërbëjnë Kuvendin para kësaj date, ngase me këtë datë hyn në fuqi dispozita ligjore e cila thotë se deputeti që nuk punon askund mund ta marrë pagën edhe për një vit.

"Epoka e re": Do të thotë kjo se partitë politike deklarimet e tyre për zgjedhje po i bëjnë vetëm për konsum të brendshëm politik derisa nuk kanë ndërmarrë asnjë veprim?

Tahiri: Këto parti vetëm po e shqetësojnë popullin duke treguar se janë parimore, ndërsa nuk ndërmarrin asnjë veprim konkret për ta çuar vendin në zgjedhje. Populli thotë shikoja punën e jo fjalët. Ata kanë folur, por Kadri Veseli nuk mund ta thërrasë seancën në bazë të fjalëve, por duhet që të ketë në bazë të letrës.

koalicioni. Përmes kësaj letre do të duhej të tregonin se nuk duan të propozojnë kandidat të ri për kryeministër ashtu si e parashih nënin 95 i Kushtetutës, por duan të shkojnë në zgjedhje të parakohshme. Po ashtu, 40 deputetë të Kuvendit mund të kërkojnë seancë të jashtëzakonshme dhe në këtë seancë të propozohet shpërndarja e Kuvendit me dy të tretat e votave ose, së paku, 80 vota. Pas shpërndarjes së Kuvendit, presidenti vetëm e dekreton datën e zgjedhjeve të cilat duhet të mbahen jo më herët se tridhjetë ditë dhe jo më vonë se 45 ditë pas shpërndarjes së Kuvendit. Presidenti Hashim Thaçi ka thënë se këtë javë do t'i thërrasë në konsultime partitë politike duke respektuar Kushtetutën dhe ligjet e vendit. Presidenti mund t'i thërrasë të gjitha partitë bashkë. Nëse dëshiron që çdo ditë ta thërrasë nga një parti atëherë ai e zgjatë procedurën që, edhe po të dojë t'i caktojë zgjedhjet, nuk mundet para muajit tetor.

"Epoka e re": Meqenëse të gjitha partitë kanë shprehur gatishmëri për zgjedhje të reja, cili do të ishte veprimi më i duhur në këtë çast?

Tahiri: Unë tregova se çfarë mund të bëjnë. Pra, mund t'i dërgojnë presidentit letër secila parti, mund të dërgojnë letër në Kuvend për të kërkuar seancë të jashtëzakonshme. Procedura më e shkurtër të cilën e njeh ligji dhe e cila i shkurton të gjitha procedurat e tjera është të thirrret seancë e jashtëzakonshme dhe të shpërbëhet Kuvendi të cilën gjë e premtoi të hënën edhe

"Epoka e re": Si njohës i rrethanave politike, sa besoni se zgjedhjet e reja do të jenë zgjidhje për Kosovën?

Tahiri: Po. Sepse nuk ka zgjidhje tjetër. Edhe qeveria Haradinaj, pa dashur t'ia mohoj meritat, si qeveri e pakicës ka prodhuar nervozë në popull, sepse nuk i ka shtyrë vendimet dhe nuk ka qenë shumë legjitime. Çdoherë nëpër seanca është dashur të priten deputetë për të filluar seanca. Kurse opozita nuk e kishte shumicën për ta rrëzuar dhe ishim në një situatë pat pozicion. Besoj se zgjedhjet janë zgjidhje, sepse është prishur pak balanca e forcave politike dhe këtë balancë e ndreqin zgjedhjet.

"Epoka e re": Mendoni se subjektet politike do të shkojnë të vetme në zgjedhje për ta provuar veten apo sërish do të kemi koalicionet e mëdha parazgjedhore sikurse herën e fundit?

Tahiri: Nuk do të dëshiroja që partitë politike të shkojnë në zgjedhje me koalicionet joparimore, sepse këto koalicionet po shkaktojnë frustrim. Partitë politike do të duhej që në zgjedhjet e reja të shkojnë vetë, ndërsa koalicionet të bëhen pas zgjedhjeve. Ramush Haradinaj po thotë se po shkojnë në zgjedhje sepse partia e tij, AAK-ja, është rritur, kurse PDK-ja po thotë se nuk do të bëjë koalicionet, sepse të gjithë e respektojnë forcën e tyre elektorale. Po ashtu, shpresoj që as LDK-ja nuk do t'i marrë partitë e vogla sikurse i ka marrë më herët dhe pastaj i kanë ikur. Pra, më mirë të gjitha partitë ta masin fuqinë e tyre veç e veç.

NË NJËVJETORIN E VDEKJES, BEKIM LUMI VLERËSOHET PËR VEPRAT E TIJ NË ARTË

PRISHTINË, 30 KORRIK- Me rastin e njëvjetorit të shkuarjes në amshim të regjisorit të mirënjohur, profesorit universitar, Bekim Lumi, është mbajtur të martën manifestim përkujtues në Teatrin Kombëtar të Kosovës me moton "Unë besoj në teatër".

Në këtë akademi të pranishëm ishin familjarë, aktorë e shumë persona të tjerë që deshën artin e Bekim Lumit.

Gjatë kësaj akademie Bekimi është kujtuar si figurë e rëndësishme e artit në Kosovë, duke nderuar me këngë e vargje kushtuar atij.

Këngëtarja Shpresa Gashi ka thënë se Lumi do të kujtohet gjithnjë për punën e tij që ka bërë në kulturë. "Ne e njohim Bekimin si njeri të artit dhe të letrës, qoftë i përgjeshëm kujtimi për Bekim Lumit", ka thënë ajo.

Kurse aktorja Melihate Ajeti ka theksuar se të gjithë ata që punuan me Bekim Lumit kanë qenë të bekuar. "Bekimi ka qenë i bekuar gjithashtu të bekuar kanë të gjithë ata që punuan me Bekimin, veçanërisht e ka dashur gjuhën shqipe ai me kujdes e ka kultivuar atë edhe tek aktorët", është shprehur ajo.

Ndërkaq regjisori Fadil Hysa ka vlerësuar aktorin e ndjerë, duke thënë se populli duhet të besojë në artë. "Bekimin e kam njohur prej kur ka dashur të bëhet aktor. Ky popull duhet të fillojë të besoj në artë nëse dëshiron për të parë të ardhme.



Shqiptarët janë dëshpëruar në gjithçka. Bekim Lumi ka qenë këmbëngulës. Ai me sëmundjen e rëndë që ka pasur ka punuar shfaqje, dhe kësaj i thonë dashuri e lartë ndaj artit", është shprehur regjisori Hysa.

Lumi ishte një ndër regjisorët më të vlerësuar në fushën e teatrit në Kosovë, profesor në Fakultetin e Arteve në Universitetin e Prishtinës. Ai është vlerësuar me Mirënjohje Speciale "Sound of MESS" me

shfaqjen "Këmisha e gjakut", Festivali Ndërkombëtar i Teatrit MESS, Sarajevë (Bosnje e Hercegovinë).

Në vitin 2011 ka marrë çmimin "Shfaqja më e mirë muzikore" për shfaqjen "Çifti Martin", Festivali Ndërkombëtar i Teatrit Kamertal - Vratza (Bullgari).

Çmimi "Shfaqja më e mirë" - Shfaqja "Mësimi", Festival International del Teatro - Lugano (Zvicër).

Bekim Lumi u nda nga jeta më 30 korrik 2018 pas një sëmundje.



Juniku nënshkruan marrëveshje për platformën digjitale për pjesëmarrje publike

JUNIK, 30 KORRIK (ER) - Kryetari i Komunës së Junikut, Agron Kuçi, ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me APPDEC për zhvillimin e platformës digjitale me qëllim të përmirësimit të

transparencës së veprimeve qeveritare dhe rritjen e pjesëmarrjes publike në vendimmarrje. Kjo platformë i mundëson banorëve të ndajnë ide, diskutojnë dhe votojnë

planet me ndikim në përmirësim të qytetit të tyre, angazhon banorët për hartimin e politikave dhe ekzekutimit dhe rrit bashkëpunimin në mes të qytetarëve dhe zyrtarëve

komunalë në mënyrë produktive. Zhvillimi dhe zbatimi i platformës digjitale për pjesëmarrjen e publikut financohet nga misioni i OSBE-së në Kosovë (OMiK).



Pallati i Rinisë nuk ka më asnjë borxh



PRISHTINË, 30 KORRIK (ER) - Për herë të parë në 15 vjetët e fundit, Pallati i Rinisë është pa borxhe. Kështu ka thënë kryetari i Komunës së Prishtinës, Shpend Ahmeti. Ai përmes një postimi në llogarinë e vet në "Facebook" ka bërë me dije

se kanë paguar të gjitha vendimet gjyqësore si pasojë e zjarrit në vitin 2000. "Për vite me radhë, para marrjes në menaxhim, kamata e vendimeve është shtuar me ç'rast Pallati është rënduar edhe më shumë. Me vendim të Komunës së

Prishtinës tashmë borxhet janë paguar dhe gjendja është normalizuar. Me këtë rast ka përfunduar faza emergjente e vlerësimit të borxheve dhe pagesave. Kjo ka qenë faza e parë pas kthimit të Pallatit në

Ndërmarrje Komunale. Tashmë kemi filluar fazën e dytë të përgatitjes së investimeve në pjesën e rinisë ku ka qenë ASK dhe ku është Salla e Kuqe. Po ashtu, kemi filluar punët përgatitore për projektin e renovimit të sallës së djegur apo

Sallës së Madhe", ka thënë Ahmeti. Ai ka shtuar se po planifikohet edhe renovimi i të gjitha sallave, zhveshtoreve dhe ambienteve të tjera në institucionin më të madh sportiv në vendin tonë.

Fillojnë dëgjimet buxhetore në Skenderaj

SKENDERAJ, 30 KORRIK (ER) - Komuna e Skenderajt, ashtu sikur vitin e kaluar që kishte mbajtur numër të madh të dëgjimeve buxhetore, ka nisur edhe për këtë vit ciklin e këtyre dëgjimeve, me pjesëmarrje të madhe të qytetarëve, fillimisht në Bashkësinë Lokale të Prekazit të Epërm, ku kanë marrë pjesë kryetari i komunës, Bekim Jashari, nënkryetari Nuredin Lushtaku dhe drejtorët komunalë.

Në fillim të dëgjimit kryetari Jashari, duke i falënderuar qytetarët për pjesëmarrje, ka folur rreth investimeve publike që janë u bërë në komunën tonë në çdo segment të jetës, ndërkohë ka përmendur edhe ndërtimin e sallës së sportit në oborrin e shkollës në Prekaz si dhe projekte të tjera në infrastrukturën rrugore, trajtimin e ujërave të zeza,



ujësjellës, bujqësi, arsim dhe të tjera. Banorët kanë kërkuar mbështetjen e komunës sa iu përket disa intervenimeve në rrjetin e trajtimit të ujërave të zeza, për çka kryetari Jashari u premtoi zgjidhje të proble-

meve. Dëgjimi i dytë është mbajtur edhe në Klinë të Epërme, ku edhe në këtë takim numri i qytetarëve pjesëmarrës ishte i madh. Kryetari Jashari ka përmendur edhe në këtë dëgjim investimet e komunës jo vetëm në

Klinë të Epërme, por në çdo fshat të komunës sonë, me qëllim të ngritjes së mirëqenies së qytetarëve tanë.

Kryetari i komunës ka thënë se janë mbi 95 kilometra rrugë që do të asfaltohen, projekte këto që do të

fillojnë këtë vit dhe që do të vazhdojnë edhe gjatë viteve të ardhshme. Jashari ka theksuar se në Klinë të Epërme pritet renovimi i Qendrës së Mjekësisë Familjare dhe investime të tjera në rrugë, kanalizime, ujësjellës, bujqësi dhe fusha të tjera. Sa iu përket këtyre dëgjimeve, kryetari Jashari ka vendosur standard të ri, pasi vitin e kaluar janë mbajtur 14 dëgjime të tilla. Edhe sivjet do të vazhdohet në të njëjtën mënyrë. Meqë praktikisht me këto dëgjime po fillon hartimi i buxhetit për vitin e ardhshëm, në këtë mënyrë kryetari Jashari dhe komuna do të jenë më afër qytetarit dhe kërkesave të tyre për investime në mjediset ku ata banojnë, e rrjedhimisht po përmbushen edhe premtimet e tij për transparencë të plotë dhe llogaridhënie.

Asfaltohet rruga Samadrexhë - Nadakoc

Vushtrri, 30 korrik (ER) - Ministri i Infrastrukturës dhe Transportit, Pal Lekaj, të martën ndoqi nga afër asfal-

timin e rrugës magjistrale Samadrexhë - Nadakoc, Komuna e Vushtrrisë. Banorët e kësaj ane e falënderuan min-

istrin Lekaj për asfaltimin e kësaj rruge me rëndësi për ta, rehabilitimi i së cilës ka qenë nevojë e kamotshme. Kjo

rrugë është e gjatë afër dy kilometra dhe po realizohet në kuadër të mirëmbajtjes së rrugëve.



Diplomon gjenerata e 41-të e kadetëve të Shërbimit Korrektues

Certifikohen 119 oficerë korrektues të Shërbimit Korrektues të Kosovës

Në një ceremoni të organizuar nga Shërbimi Korrektues i Kosovës (ShKK) dhe Akademia e Kosovës për Siguri Publike, të martën janë certifikuar 119 oficerë korrektues të gjeneratës së 41-të të Shërbimit Korrektues të Kosovës, të cilët pritet ta fillojnë angazhimin e tyre në Burgun e Sigurisë së Lartë dhe në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

**EPOKA
ERE** **Qendresa RAMA**

VUSHTRRI, 30 KORRIK - Të martën janë certifikuar 119 oficerë korrektues të gjeneratës së 41-të të Shërbimit Korrektues të Kosovës, të cilët pritet ta fillojnë angazhimin e tyre në Burgun e Sigurisë së Lartë dhe në Qendrën e Paraburgimit në Gjilan.

Në ceremoni morën pjesë ministri në detyrë i Drejtësisë, Abelard Tahiri, drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Kosovës, Rashit Qalaj, drejtori i Përgjithshëm i ShKK-së, Nehat Thaçi, drejtori i AKPS-së, Ismail Smakiqi, si dhe përfaqësues të tjerë të institucioneve vendore dhe ndërkombëtare. Në fjalën e tij ministri i

Drejtësisë, Abelard Tahiri, ka theksuar se pjesë e trashëgimisë së tij, krahas ligjeve vitale për qytetarët, është pikërisht avancimi në sistemin korrektues të Republikës së Kosovës. "Infrastruktura ka shënuar përmirësim të plotë dhe vazhdon të përmirësohet edhe sot. Qendra të reja janë hapur e ato të vjetrat janë rinovuar. Kemi menaxhim efikas të procedurave standarde të veprimit dhe kemi ulur për herë të parë në një nivel të plotë, dukuritë negative brenda burgjeve. Sot Qendrat Korrektuese nuk janë as për së afërmi ato që kanë qenë dikur dhe të njëjtat i kemi vendosur në një kurs të pakthyeshëm drejt avancimit, standardeve



dhe respektimit të ligjit", ka thënë ministri Tahiri.

Ministri Tahiri ka uruar gjeneratën e re të kadetëve, duke kërkuar nga ta të përkushtohen në zbatimin e ligjit. "Ngjashëm do të definohet nga përkushtimi juaj për t'i dhënë njeriut dinjitetin që i

takon, pavarësisht faktit se ai mbahet në korrektim. Dhe në mes të kësaj pune, përkushtimi juaj është ai që do ta bëjë dallimin, në rast se qendrat tona korrektuese do të jenë referencë e sundimit të ligjit apo degradimit të tij. Prandaj, për fund, duke ju dëshiruar

sukses në karrierë, avancim dhe ngritje profesionale në të ardhmen, ju ftoj ta jepni maksimumin tuaj që këtij segmenti të rëndësishëm të zbatimit të ligjit, t'i jepni dimension kuptimplotë, efikas dhe të përgjegjshëm", është shprehur ministri Tahiri.

Përuroheshin laboratorët e kalibrimit të radarëve dhe alkoolmetrave

**EPOKA
ERE** **Faton DËRMAKU**

PRISHTINË, 30 KORRIK - Ministri i Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, bashkë me drejtorin e Policisë së Kosovës, Reshat Qalaj, kanë bërë të martën përuroren e dy laboratorëve të Agjencisë së Metrologjisë së Kosovës.

Ministri Shala ka thënë se tash e tutje pajisjet e Policisë së Kosovës do të kalibrohen në institucionet shtetërore. "Duke pasur parasysh rëndësinë e sigurisë në komunikacion, Ministria e Tregtisë dhe Industrisë dhe Agjencia e Metrologjisë së Kosovës kanë kompletuar pajisjet e dy laboratorëve për verifikimin e matësve të shpejtësisë dhe atë të alkoolmetrit, të dy këto pajisje me të cilat shërbehen Policia e Kosovës do të kalibrohen në Agjencinë e Metrologjisë së Kosovës. Qytetarët e vendit sigurohen që tash e tutje këto pajisje do të jenë të kalibruara në Republikën e Kosovës", ka thënë ministri Shala.

Ai ka bërë me dije se ky është edhe një veprim në kuadër të mbrojtjes së konsumatorit dhe tashmë Policia e Kosovës do të jetë edhe më e saktë sepse mjetet që përdoren nga to do të jenë të kalibruara. "Me këtë veprim ne sot edhe një herë po dëshmojmë gatishmërinë politike dhe institucionale për ngritjen e nivelit të zbatueshmërisë së ligjit në funksion të rritjes së sigurisë në rrugët e Republikës së Kosovës, gjithashtu edhe rritjen e transparencës dhe përgjegjësisë ndaj të gjithë ngasësve të veturave në Republikën e Kosovës", ka thënë ministri Shala.

Ndërsa kryeshefi i Agjencisë së Metrologjisë, Ferki Fejza, ka thënë se këta dy laboratorë ndikojnë në punën e përditshme të policisë dhe e rrisin besueshmërinë e matjeve edhe në konteste gjyqësore. "Sepse matjet që i kryen Agjencia e Metrologjisë janë profesionale dhe janë laboratorë të sofistikuar që janë kompletuar me infrastrukturë moderne", është shprehur Fejza.



E drejtori i Policisë së Kosovës, Reshat Qalaj, tha se policia tash e tutje do t'i shfrytëzojë institucionet shtetërore për kalibrimin e mjeteve të tyre të punës.

"Edhe në të kaluarën edhe sot jemi duke punuar me instrumente të kalibruara dhe testuar, mirëpo kemi shfrytëzuar shërbimet e operatorëve privatë të

kontraktuar. Tash këto shërbime do t'i kryejmë në institucione shtetërore dhe sigurisht me një kosto shumë më të lirë", ka thënë Qalaj.

'Banana Republikat Ballkanike'



Prof. Dr. Blerim REKA

Çereku i Ballkanit iku në Perëndim, para "perëndizimit" të rajonit. Sa më shumë që elitat e korruptuara ballkanike premtojnë afrimin me Perëndimin, aq më shumë qytetarët e tyre largohen nga vendi. Para integritimit të shteteve të tyre, qytetarët tashmë u "integruan" në BE.

Ky proces i integritimit individual para atij shtetëror duket se u konvenon të dyja palëve. Qytetarëve për të ikur nga joperspektiva, kurse "establishmenteve" për të mbetur më gjatë në pushtet jashtë radarit kontrollues të Brukselit. Humbi kështu një gjeneratë e tërë postkomuniste, duke i besuar idealit të demokracisë me sundim ligji. Të lindur para tre dekadave, ata më nuk janë në Ballkan, por atje ku jetojnë këto ideale. Pas tyre shkuan edhe gjenerata të tjera, duke rrezikuar zbrazjen e rajonit. Ndoshta Ballkani edhe do të integrohet një ditë në BE, por me shtete të zbrazëta. Ballkanasit e rëndomtë u besuan me vite broçkullave se sundimi i ligjit është kyç për

integrimin euroatlantik.

Sot po binden se mossundimi i ligjit i ndëshkoi vetëm ata, por jo edhe qeveritë e tyre. Qytetarët e thjeshtë mbetën të zhgënjyer, por jo edhe qeveritë e tyre. Autokratët lokalë zbuluan se në vend të sundimit të ligjit, mund të sundojnë me ligj. Vendosën feudalizmin e vëllazërive, duke krijuar shtetarë të pasur në shtete të varfra. Nafta, cigarja, droga, kazinot dhe prostitucioni kontrolloheshin brenda feudeve strikte të përcaktuara, ndërkaq jashtë, pa marrë parasysh fjalorin nacionalist, lulëzonin aleancat e krimit trans-kufitar të "atdhetarëve të mëdhenj". Kështu, rajoni inauguroi një fenomen të ri se gjithkund ka mafi, por në Ballkan mafitë kanë shtetet e tyre. Ballkanasit shpikën kazino-kapitalizmin që mbahet nga larja e parave.

Këshilli i Evropës përmes "Raporteve Greco" alarmon me vite se Ballkani është bërë lavatriqe e parasë së pistë. Riciklimi i "establishmenteve" shtetërore në të gjitha zgjedhjet vetëm "legjitimonte" të njëjtit, për të cilët elektorati nuk zgjidhte programin politik, por votonte vazhdimin e zhatjes së buxhetit. Votat siguroheshin nga administrata shtetërore, sepse shteti mbeti punëdhënësi kryesor. Jorastësisht Brukseli me vite alarmon për tejkalimin për disa herë të numrit të shërbyesve civilë në raport me numrin e popullsisë. Me kot kjo administratë shtetërore jo që nuk zvogëlohej, por vazhdoi të rritej,

e me të edhe votat e sigurta për pushtetin. Në çdo cikël elektoral votohej partia në pushtet, sepse votuesi i tyre varej nga rroga e shtetit.

Ky "inxhinjering" elektoral postkomunist ballkanik i bëri qytetarët vetëm pagues të tatimeve, të cilat i "administronin" qeveritarët; në emrin e tyre, por pa llogaridhënie ndaj tyre. Zhatja e buxhetit zëvendësoi premtimet e mëdha elektorale. Tenderizmi zëvendësoi "nacionalizmin". Shitësit e flamujve kombëtarë interesoheshin për paranë kombëtare. Kryeministri kroat Sanader, ndonëse lider i partisë nacionaliste kroate, përfundoi në burg për zhatje buxhetore. Asnjë koleg i tij nga Ballkani ndërkaq nuk përfundoi në burg. Qytetarët, me votën e tyre, pra vazhduan t'i "legjitimojnë" zhatësit e buxhetit që mbushet nga xhepat e tyre. Kur qytetarët u ankohen ndërkombëtarëve për keqqeverisje, përgjigja e tyre standarde është "ju vetë i keni votuar". Po, pikërisht, i kishin votuar, por jo zgjedhur. Votimi: me kuti të mbushura, me shantazhe e kërcënime, apo me blerje votash, nuk është zgjedhje e lirë. Aq sa mund të konsiderohen zgjedhje, ato ku aplikohet "treni bullgar" apo ndalja e rrymës pak para përfundimit të votimit! Mirëpo, tash e tridhjetë vjet pas komunizmit, ODHIR dhe ambasadorët e huaj vetëm konstatojnë parregullsitë të cilat përsëriteshin në zgjedhjet e ardhshme. Në zgjedhjet e reja

pastaj kandidonin madje edhe të dënuarit gjyqësor për shkelje elektorale. Të gjitha diheshin, pos nga vëzhguesit ndërkombëtarë. Mandatet e tyre ishin të përkohshme dhe ata duhej arsyetuar punën e vet.

Diplokracia mbylli sytë para stabilokracisë. Sundimi i ligjit dhe demokracia u flijuan para sigurisë. Qeverisja e mirë para oligokracisë. Ndërkombëtarët ranë në kurthin e bosëve ballkanikë, se "pa ta rajoni mund të rrëshqiste drejt alternativave të tjera strategjike". Por, shantazhimi i tyre ishte pikërisht i kundërt: korrupsioni institucional i këtyre qeverive ishte dera e hapur për lojtarët joperëndimorë. Prandaj, jorastësisht shtetet që kundërshtonin integrimin euroatlantik të rajonit zyrtarisht mbronin koalicionet e qeveritarëve të korruptuar. Por, pse toleroheshin edhe nga perëndimorët? Zyrtarët ndërkombëtarë i takonin dhe vazhdojnë t'i takojnë edhe ata me dosje kriminale edhe ata që i kishin vendosur në lista të zeza. Takonin shtetarët e korruptuar, ndërkaq që përsërisin domosdënë e shtetit të së drejtës. Atij që sundohej nga shkelësit e ligjit? Cilët shtet? Atij ku Kushtetuta është bërë monedhë pa vlerë e tregtisë konstitucionale të partive? Shtetit ku nuk funksionon Gjykata Kushtetuese? Atij ku Gjykata Supreme për një vit nuk shqyrton asnjë lëndë? Ku Supremja interpreton ligjin, në vend të Kuvendit, e ky i fundit i

raporton qeverisë dhe jo e kundërta? Ku Kuvendi është shndërruar në fotokopjues të ligjeve qeveritare? Ku Prokuroria Speciale, e krijuar mu nga ndërkombëtarët, lejohet të shuhet nga aksham pazaret vendore? Ku shteti dënon për rryshfet minor, po assesit për kurdisje tenderësh madhorë?

Në Ballkan "Republika" mbeti vetëm fasadë e një rendi të dëshiruar ligjor. "Banana Republikat" e shekullit të kaluar u zëvendësuan nga republikat ballkanike në fillim të këtij shekulli. Nga shtete të kapura, ato po rrëshqasin drejt shteteve të dështuara. Kapotë ballkanike toleroheshin në emër të stabilitetit rajonal, sepse edhe vetë ndërkombëtarët ishin të bindur se para shteteve demokratike duhej mbajtur dosido sigurinë rajonale. E pa: "capo di tuti capo", kjo dukej e pamundur.

Perëndimi, një herë gaboi në Ballkan, me besimin e pazezervë ndaj Millosheviqit, pa të cilin, siç raportonin diplomatët e atëhershëm, "nuk mund të arrihet paqja në Ballkan". Fatkeqësisht, edhe sot ndërkombëtarët për hir të stabilitetit rajonal, vazhdojnë të mbyllin sytë para kollumbizimit të rajonit. Nëse kjo edhe mund të arsyetohej disi para tre dekadash, kur Ballkani nuk kishte asnjë shtet anëtar të NATO-s. Pse sot, kur, pos Serbisë dhe Bosnjës, të gjitha të tjerat janë nën ombrellën e sigurisë së aleancës veriatlantike?

Fillojnë punimet për asfaltimin e rrugëve në fshatin Cërmjan të Gjakovës



GJAKOVË, 30 KORRIK (ER) - Të martën kanë filluar punimet për asfaltimin e rrugëve në fshatin Cërmjan të Komunës së Gjakovës. Me rastin e fillimit të punimeve në

këto rrugë ishte i pranishëm kryetari i Komunës së Gjakovës, Ardian Gjini, dhe kryetari i Degës së Nismës Socialdemokrate në Gjakovë, Fazli Hoxha, parti kjo e

cila është pjesë e koalicionit qeverisës me AAK-në këtë qytet. "Jam i lumtur që koalicioni lokal AAK-Nisma Socialdemokrate dhe partitë e tjera po realizon premtimet e dhëna për infrastrukturë rrugore. Nisma Socialdemokrate në këtë qeverisje lokale është duke dhënë kontributin për mirëqenien e qytetarëve të Komunës së

Gjakovës. Deri në përfundim të mandatit të qeverisjes lokale të gjitha rrugët si në qytet ashtu edhe në fshatra do të përfundojnë komplet", ka deklaruar Fazli Hoxha.

Telekomi i Kosovës shkëput kontratën me 'Z-Mobile'

Telekomi i Kosovës ka shkëputur të martën kontratën me kompaninë telefonike "Z-Mobile". Në një konferencë për media kryetarja e Bordit të Telekomit, Besa Shatri-Berisha, ka njoftuar se pas gjashtë muajve bisedime të pasuksesshme me "Z-Mobile", kanë shkëputur kontratën. Ndërkaq kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka njoftuar konsumatorët që shfrytëzojnë shërbimet e "Z-Mobile" se për ta nuk do të paraqitet asnjë problem

EPOKA E RE Albulena S. MAVRAJ

PRISHTINË, 30 KORRIK - Telekomit i Kosovës e ka shpallur të përfunduar kontratën me kompaninë "Z-Mobile", të cilën e kishte vlerësuar shumë të dëmshme. Kjo kontratë ishte nënshkruar para dhjetë vjetësh, kurse afati i skadonte të martën, më 30 korrik.

Kryesuesja e Bordit të Telekomit të Kosovës, Besa Shatri-Berisha, në një konferencë për media ka pohuar se kontrata me "Z-Mobile" është ndërprerë. Deri te ky vendim, sipas saj, erdhë pas një periudhe gjashtëmuajore të negociatave në mes të Telekomit dhe kompanisë "Z-Mobile" në lidhje me kushtet e reja kontratës, por në fund palët nuk kishin arritur ndonjë marrëveshje. "Bordi i drejtorëve njofton se pas një periudhe gjashtëmuajore nuk kanë arritur marrëveshje mbi kushtet e reja, prandaj sot kryeshefi ekzekutiv ka dërguar njoftim me vendim të Bordit për shpallje të pasuksesshme për përfundim të kontratës me 'Z-Mobile' nga data 31 korrik", ka thënë Shatri-Berisha.

Edhe kryeshefi ekzekutiv i Telekomit të Kosovës, Bedri Istrefi, ka thënë se pas dështimit të negociatave, kontrata me "Z-Mobile" shpallet e përfunduar dhe pa asnjë obligim kontraktual. "Bordi i Drejtorëve të Telekomit në mbledhjen e djeshme më ka autorizuar për ta shpallur publikisht përfundimin e pasuksesshëm të negociatave dhe ndërprerjen e çdo raporti kontraktues mes Telekomit dhe Dardafon-it (Z-Mobile). Kompania Dardafon

është njoftuar zyrtarisht gjatë ditës së sotme për mosvazhdimin e çdo raporti kontraktues mes dy kompanive tona", ka thënë Istrefi.

Ai i ka njoftuar konsumatorët që shfrytëzojnë shërbimet e "Z-Mobile" se për ta nuk do të paraqitet asnjë problem. "Të gjithë konsumatorët që shfrytëzojnë shërbimet e Dardafon (Z-Mobile) të mos bien në panik, sepse në bashkëpunim në Autoritetin Rregullativ të Komunikimeve Elektronike dhe Postare të Kosovës (ARKEP) jemi duke punuar ngushtë që ta

zbatojmë edhe fazën e tranzicionit që do të zgjasë nga 30 deri 120 ditë", ka thënë Istrefi.

Në kundërshtim të vazhdimisht kësaj kontrate vazhdimisht kanë qenë edhe punëtorët e Telekomit, të cilët që dy ditë kanë mbajtur grevë të përgjithshme.

Telekomi i Kosovës dhe kompania "Z-Mobile" në vazhdimësi kanë pasur mosmarrëveshje në lidhje me një kontratë të nënshkruar 10 vjet më parë, e cila i kishte mundësuar kompanisë "Z-Mobile" të ishte operator virtual i telefonisë mobile "Vala". Mospajtimet mes palëve kishin nisur kur "Z-Mobile" kërkoi numra shtesë. Çështja kishte shkuar në Arbitrazh dhe më pas Gjykata e Prishtinës kishte vendosur në favor të kompanisë "Z-Mobile".

Ndërkaq për dëmin e shkaktuar ndaj kompanisë "Z-Mobile", Telekomit i Kosovës obligohej t'i lëshonte numra shtesë "Z-Mobile", t'i ofronte shërbimet 3G dhe 4G dhe të paguante një gjobë mbi 25 milionë euro në

emër të shpagimit të dëmit, fitimit të humbur dhe shpenzimeve të procedurës së arbitrazhit.

Pas të gjitha këtyre mosmarrëveshjeve dhe dëmshpërblimeve, Telekomit hyri në krizë financiare.

Ministri i Zhvillimit Ekonomik, Valdrin Lluka, ka thënë për gazetën "Epoka e re" se gjendja në Telekom është rënduar dhe ka probleme financiare. "Ne tashmë jemi në proces të ristrukturimit të Telekomit të Kosovës në bazë të marrëveshjes që kemi me BERZh-in dhe besoj se pas gjashtë muajve Telekomit do të jetë në fazën e privatizimit", ka thënë ai.

Kryetari i Komisionit Parlamentar Hetimor për Telekomit, Visar Ymeri, ka thënë se kjo kontratë i ka shkaktuar dëme të mëdha financiare dhe ngarkesa të papërbalueshme tekniko-teknologjike Telekomit të Kosovës. "Përveçse është dëmtuar kompania më e suksesshme publike e Kosovës,

janë dëmtuar edhe abonuesit e saj, pra qytetarët e Kosovës, shërbimet e komunikimeve elektronike, të cilët kanë pësuar një degradim të vërejtshëm", ka thënë Ymeri.

Ai ka thënë se Autoriteti Rregullativ i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (ARKEP) duhet menjëherë të vendosë që 300 mijë numrat në përdorim të 'Z-Mobile' t'i kthehen kompanisë që e ka autorizimin individual për përdorim të numeracionit, Telekomit të Kosovës në mënyrë që të shfrytëzohen nga "Vala 900".

Telekomi i Kosovës është kompani publike e transformuar në shoqëri aksionare, në të cilën operon telefonia fikse dhe ajo mobile "Vala". Operatori "Vala" ka mbi 1.2 milion konsumatorë në nivel vendi. Kjo kompani ka përafërsisht 2 400 punonjës, kurse paga mesatare llogaritet të jetë mbi 730 euro. Qeveria e Republikës së Kosovës është pronare e 100 për qind të aksioneve të Telekomit të Kosovës.



Naftëtarët kundërshtojnë pastrimin e rezervuarëve çdo tre vjet

PRISHTINË, 30 KORRIK (ER) - Shoqata e ndërmarrjeve që merren me qarkullim të naftës, derivateve të naftës, gazrave dhe lubrifikanteve (ShQNG), ka kundërshtuar vendimin e ministrit të Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shala, që obligon kompanitë që shesin derivat, t'i pastrojnë rezervuarët çdo tre vjet.

Kryetari i Shoqatës, Fadil Berjani, në një konferencë për media të martën, ka thënë se kanë pasur takim me ministrin e Tregtisë dhe Industrisë, Endrit Shalën, porse nuk janë marrë parasysh kërkesat e tyre. Ai ka thënë se është për t'u habitur se një ministër në largim merr një vendim të tillë dhe i lë naftëtarët në një pozitë të keqe, ku

nuk kanë as ku të ankohen. "Askund në botë nuk bëhet pastrimi i rezervuarëve. Qytetarët duhet ta kuptojnë se pastrimi i rezervuarëve nuk iu bënë mirë qytetarëve, vetëm dëm, pasi një pastrim i tyre kushton rreth 700 euro. Nuk është në rregull që pastrimi i rezervuarëve të bëhet çdo tre vjet", ka thënë Berjani.



Me rastin e njëvjetorit të vdekjes së Adem Demaçit, 26 korrik 2018 (7)

ADEM DEMAÇI, HERO I KOSOVËS DHE NDERI I KOMBIT

- Përshtypjet në "librin e zisë"



Përgatiti: Selatin Novosella

- Përshtypjet në "librin e zisë"

Bacë, Ti ma largon vdekjen!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Respekt për HEROIN E KOSOVËS dhe të SHQIPËRISË!

27 korrik 2018,
Basri Misini

Lirinë nuk ua solla unë, por e gjeta në mesin tuaj! Do vazhdojmë idealin e nisur nga Ju për Shqipërinë e bashkuar...

27 korrik 2018,
Xhemal Aliu, Lipjan

Ju ishit dhe do të jeni liria e Kosovës dhe të gjithë shqiptarëve!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ju ishin dhe mbeteni krenaria e Kombit Shqiptar! Respekt!

27 korrik 2018,
Vehbi Zeqiri

Lavdi jetës dhe veprës së Heroit të Kombit! Lavdi Bacës Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Bali (mbiemri i palexueshëm)

I nderuari, z. Baca Adem Demaçi, ishe dhe mbetesh model për të kenë shqiptar!

27 korrik 2018,
Ismet Latifi

Ike për të mos vdekur kurrë! Dheu i lehtë të qoftë, Baca Adem!

27 korrik 2018,
Bujar Lepaja

Do të iu kujtojmë sa të jetë jeta! Zoti bëftë rahmet në ju për aq shumë që keni bërë për ne!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ishe dhe do të mbetesh për jetë njeriu të cilin e çmova, respektova dhe e desha si baba! Lavdi

veprës Tënde!

27 korrik 2018,
Fixhrie Bilalli Shala

Shëmbëlltyrë e thjeshtësisë më të bukur, veprimi të pareshtur e vullnetit të paepur, Baca Adem! Qofshi udhëzues i përhershëm me vlerat që na i mësove. Ishe mishërim i vullnetit të pakthyeshëm, atdhedashurisë së pareshtur, pishtar i drejtimit të pakthyeshëm për kombin, flamurin dhe popullin. Baca Adem, idealet dhe veprat tuaja na ndriçofshin rrugën përjetësisht!

27 korrik 2018,
Ushitari Yt, Blin B. Shala

Në kujtim të kuptimit të jetës dhe vlerave të pamasë siç janë njerëzorja dhe liria pa kufij, pa dallim dhe për të gjithë! Gjatë do jetojë kujtimi për mendjen dhe shpirtin tuaj të madh, Baca Adem!

27 korrik 2018,
(emri i palexueshëm) Shala

Linde trëndafil, u rrite trëndafil dhe vdiqe për të mos vdekur kurrë, prapë si Lulëkuqe e kombit tënd! Lavdi, Bacë!

27 korrik 2018,
Selajdin Hajrullahu

Do të mbetesh Legjendë si simbol i Lirisë së shqiptarëve!

27 korrik 2018,
Hashim Krasniqi, Qerret, Kavajë

Lavdi jetës dhe veprës Tënde! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës. Lavdi!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

I nderuari Baca Adem! Respekt jetës dhe veprës suaj, mik i dashur!

27 korrik 2018,
Nezir Gashi

Respekt Bacë, nuk u rrëzove asnjëherë! Përherë qëndrove në këmbë!

27 korrik 2018,
Xheva Shala

Lavdi jetës dhe veprës Tënde! Lavdi guximit Tënd! Lavdi qëndresës Tënde!

27 korrik 2018,
Endrit Shala

Me vepër nderove gjithë kombin shqiptar! Lavdi e përjetshme Bacë!

27 korrik 2018,
R. Misini

Kjo është një humbje e madhe për gjithë kombin shqiptar. Lavdi jetës dhe veprës së Bacës Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Lavdi veprës suaj patriotike!

27 korrik 2018,
A. Gashi

Thellë ka lëshuar rrënjë në memorien e popullit shqiptar, jeta dhe vepra e juaj kombëtare, Baca Adem! Të pashlyera do të mbesin kujtimet për të madhin legjendën e kombit tonë! Përgjithmonë do kemi dhembje për Ty. Do vazhdojmë veprën Tënde më të gjitha fuqitë tona! Unë një bashkëveprimtar i vogël Yti!

27 korrik 2018,
Sadik Krasniqi

Nder e Lavdi heroit tonë kombëtar, zotit Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
(nënshkrimi i palexueshëm)

Ndriçim për shqiptarët! Dritë për Kosovën! Dritë për Shqipërinë! Lavdi Bacës Adem Demaçi

27 korrik 2018,
Tahir Bajgora

Nder e Lavdi heroit tonë kombëtar, zotit Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
A. Hajzeraj

Do ta kujtojmë Bacën gjithmonë si njeri të papërkulur dhe të pamposhtur në luftën e tij për liri dhe bashkim, i cili tërë jetën ia kushtoi kësaj kauze kombëtare!

27 korrik 2018,
Familja Fazliu

Baca Adem është ajo figurë e pavdekshme që do të jetojë përjetësisht në shpirtin e kombit tonë. Është Baca ai i cili mban flakadanin e lirisë ndezur!

27 korrik 2018,
Agim Kuleta, kryesues i Kuvendit të Prishtinës

E pata nderin të jetojë në një



shekull me Ty, Baca Adem! Pusho i qetë në dheun e Kosovës!

27 korrik 2018,
Sadik Islami

Isha i nderuar të të bëjë roje pranë arkivolit të babit të Kosovës! Të qoftë i lehtë dheu i Kosovës! Lavdi Bacës, Adem Demaçi!

27 korrik 2018,
Nebih Sylejmani, Londër

Baca Adem është kolos i atdheut, patriot i cili do të kujtohet sa të ketë popull shqiptar. Me nderime do të kujtojmë përherë!

27 korrik 2018,
Gani Bimbashi

Baca ynë Adem Demaçi kaloi në përjetësi. Qoftë i përjetshëm kujtimi për Bacën tonë, për këtë kolos të Shqiptarisë!

27 korrik 2018,
Basri Berisha

Na ishin shumë Yje, të cilët bënë dritë. Një Yll i madh papritmas u fik! E lanë të vetëm të shkrijë këtë Yll me dekada në qeli, por bënte dritë edhe aty! Lavdi!

27 korrik 2018,
Agim Vatovci

Lavdi heroit të luftës, paqes dhe demokracisë, z. Adem Demaçi! U shkri për Gjeografinë Etnike të Atdheut!

27 korrik 2018,
prof. Dr. Flori Bruçi

Lavdi Heroit të Kombit, atdhetarit e shqiptarit të vërtetë që

nuk harrohet kurrë. Ngushëllimet nuk mjaftojnë!

27 korrik 2018,
Sahit Menxhiqi

Baca Adem, Vepra Juaj na tregon se madhësinë e një kombi të robëruar nuk e tregon forca e tij, por dëshira dhe përpjekja për të qenë i lirë. Ju edhe i mbyllur e mundet perandorinë barbare serbe! Nder e respekt veprës tuaj fisnike dhe patriotike! Lavdi!

27 korrik 2018,
Ilir Kabashi, regjisor

Adem Demaçi shfaq fuqinë e pamposhtur të popullit shqiptar, duke kundërshtuar hapur rrugën e okupimit dhe i hapi rrugën lirisë, çlirimit dhe u bë NDERI I KOMBIT!

27 korrik 2018,
Imer Lladrovci

Iu përkujtoj me dhembje e me mall! Prehu në paqe Baca Adem! Ke qenë dhe do të mbetesh për jetë e mot Mendela i Kosovës. Kurrë populli nuk do të të harrojë! Lavdi

27 korrik 2018,
Xhyla Demolli


Unë Behram Hoti (Drenica) dy fjalë; Askujt, apo kujt i ka hije me i thanë ato dy fjalë ishe TI! E po kush i tha më mirë se Ti - Nëna Shqipëri! Të bekoftë Allahu!

27 korrik 2018,
Behram Hoti

(Vazhdon në numrin e ardhshëm)

Fizika simetrike, udhëtim drejt universit (14)

Zëri, shpërndarja, drita, zhurma dhe shpejtësia



**Shkruan: Naim
KRASNIQI, fizikan**

Në fotografi shihet një rreth i ndritshëm që e mbështjellë Hënën. Nëse e shikojmë pozitën e trupave qiellorë saktësisht shihet se toka së bashku me Hënën në këtë kohë ndodhet në mes Diellit dhe Jupiterit (shih figurën 53), kurse në distancë 377 837 ndodhet Hëna. Në këtë rast në trupin e Hënës takohen të paktën tri fusha antimagnetike e Jupiterit, tokës dhe diellit.

Fusha antimagnetike e diellit e bartë dritën dhe e ndriçon Hënën në anën e përparme e cila shihet edhe nga kjo pozitë. Këtë ndriçim të Hënës e ndihmon edhe fusha antimagnetike e tokës e cila rrezet e diellit i bën më të dendura afër Hënës. Ngjashëm edhe fusha antimagnetike e Jupiterit e godet anën e kundërt të Hënës me valë të errëta në këtë mënyrë e zgjeron fushën antimagnetike të diellit, përkatësisht i zgjeron rrezet e diellit për rreth Hënës. Prandaj rreth Hënës formohet një mbështjellës i ndriçuar, që vërehet nga toka, mirëpo për shkak se trupat janë në lëvizje të përhershme edhe forcat ndërrojnë kohë pas kohe, ashtu edhe mbështjellësi i ndriçuar i Hënës ndërrohet kohë pas kohe.

Argument 2

Nëse e vëzhgojmë një qytet natën në kohën me mjegull, apo nëse nga një breg e shohim një fshatë poshtë të ndriçuar shumë qartë mund të vërehet se drita e qytetit apo e fshatit ngritët në lartësi shumë lartë, në formë të gjysmër-




Fig 53




Fig 55

rethit kurse në anët anësore shumë pak (shih figurën 54).

Kjo na jep për të kuptuar se fusha antimagnetike që buron nga toka kalon vertikalisht nga qendra në drejtim të periferisë, dhe e shpërndan dritën e qytetit shumë më shumë në mënyrë vertikale, kurse këtë dritë e zvogëlon në skaje duke e ngritur përpjetë. Sikurse të mos ekzistonte kjo forcë drita nuk do të përhapej, por do të kishte mbetur në lartësinë e ndërtesave.

Zëri, shpërndarja dhe shpejtësia

Ngjashëm sikur dritën që e shpërndan fusha antimagnetike nga dielli në drejtim të trupave të tjerë qiellor, tërësisht ngjashëm edhe zërin e shpërndan fusha antimagnetike e tokës, nga burimi deri te dëgjuesi.

Argument 1

Zëri natën në nivele të njëjta të lartësisë mbi detare, dhe në dis-

tanca të shkurta shpërndahet më lehtë dhe dëgjohe shumë më mirë se sa që dëgjohe ditën. Kjo ndodhë për arsye se fusha antimagnetike që buron nga toka e shpërndan zërin nga burimi deri te dëgjuesi, kurse fusha antimagnetike që vjen nga dielli dhe e godet tokën, në një formë i izolon zërin më shumë se sa natën.

Argument 2

Nëse në një ndërtesë të lartë rreth 100 metra vendosim një regjistruer zëri në decibel, kurse në fund lëshojmë një ultra zë, atëherë regjistruerit që është lartë në 100 metra regjistron vlerën më të lartë të zërit në decibel, kurse regjistruerit tjetër që ndodhet 100 metra distancë horizontale e regjistron vlerën më të vogël, kështu që në ndërtesa të larta më shumë dëgjohe zhurma se sa në të ulëtat.

Argument 3

Dy persona ndodhen në distancë 1029 metra (shih figurën 55) njëri e godet me çekan një metal, vëzhguesi në 1029 së pari e shef personin duke goditur me çekan e pas tre e më shumë sekondave e dëgjon krismën.

Kjo ndodhë për faktin se fusha antimagnetike që buron nga toka e shpërndan zërin në drejtim ver-

тикаl, kurse zëri që shkon në drejtim horizontal e humb efektin shkon me vonesë te burimi dhe me intensitet shumë më të ulët.

Argument 4

Nëse një aeroplan fluturon 10 000 metra lartësi, natën dëgjohe shumë pak apo nuk dëgjohe aspak, por ditën nga mesi i ditës dëgjohe më shumë. Kjo ndodhë se fusha antimagnetike e diellit këtë zhurmë e kthen deri në tokë, prandaj sikur të mos largohej kjo zhurmë e aeroplanëve nën veprimin e fushës antimagnetike që buron nga toka zhurmat e aeroplanëve do të ishin absolutisht të padurueshme për ne.

Por si do që të jetë asnjë pikë në univers nuk ekziston ku nuk ka fushë antimagnetike. Edhe toka në ç' do vend përpos fushës së sajë fusha antimagnetike, ajo goditen në ç' do kohë nga fushat e tjera antimagnetike prandaj sikur gjatë natës ashtu edhe gjatë ditës zëri dhe valët shpërndahen në të gjitha anët vetëm se me shpejtësi të ndryshme.

Mirëpo intensiteti i zërit dhe koha varen edhe nëse efektet ndodhin ditën apo natën, dhe pozita e Tokës që ndodhet në sistemin solar, si shembull zëri natën dëgjohe më shumë nga qershori deri në gusht 2020. **Fund.**



Fig 54

Pse përgjigjja zyrtare ndaj protestave në Moskë mund të jetë pikë kthese?

Gati 1 400 njerëz janë ndaluar gjatë protestave në Moskë të cilat janë nxitur nga aktivistët politikë liberalë që synojnë të garojnë në zgjedhjet për këshillin e kryeqytetit më 8 shtator. Disa nga brohoritjet e dëgjura shprehnin dëshira si: "Rusia pa Putinin" dhe "Rusia do të jetë e lirë"

MOSKË, 30 KORRIK - Pamjet nga rrugët e Moskës, fundjavën e kaluar, ishin mjaft të njohura. Forcat speciale, veshur me helmë, maska të zeza dhe çizme, qëllonin protestuesit me shkopinj; disa i fushnin në automjete të blinduara. Demonstruesit, shumica në pantallona të shkurtra, bluza e atlete, regjistronin me telefona mobilë dhe thërrisnin slogane të ndryshme. Por, diçka ndryshe ka qenë më 27 korrik dhe pyetjet që shtrohen janë: çfarë saktësisht, përse tani dhe çfarë pason?

Gati 1 400 njerëz janë ndaluar gjatë protestave në Moskë, të cilat janë nxitur nga aktivistët politikë liberalë që synojnë të garojnë në zgjedhjet për këshillin e kryeqytetit, më 8 shtator. Disa nga brohoritjet e dëgjura shprehnin dëshira si:

"Rusia pa Putinin" dhe "Rusia do të jetë e lirë".

Me javë të tëra janë grumbulluar dëshmi se autoritetet zgjedhore po bëjnë përpjekje për të gjetur pretekste për të mos lejuar kandidimin e kandidatëve opozitarë, liberalë ose thjesht të pavarur.

Aktivistët e opozitës - Aleksei Navalny, Leonid Volkov, Lyubov Sobol dhe Ilya Yashin - kanë thirrur protesta për ta shprehur pakënaqësinë publike për këtë. Por, autoritetet e Moskës ua kanë bërë të qartë para kohe: Mos e bëni një gjë të tillë! Dhe, protestuesit janë ndëshkuar rëndë.

Sipas disa llogaritjeve, kjo ka qenë dhuna më e keqe që nga vala e protestave më 2011-2012. Atëbotë zemërimi ka pasur të bëjë me provat për mashtrim në zgjedhjet parlamentare dhe me

planet e Vladimir Putinit për t'u kthyer në presidencë.

Shumë prej atyre protestave janë mbajtur në Sheshin "Bolotnaja" të Moskës, përfshirë një që ka shpërthyer në dhunë midis protestuesve dhe policisë. Dhjetëra njerëz janë ndjekur penalisht në atë që është bërë i njohur si Rasti Bolotnaja.

Ashpërsia e befasishme

Për vëzhguesit e Kremlinit, reagimi luftarak i policisë në fundjavë nuk ka qenë befasi. Ashpërsia ka qenë, ashtu si edhe numri i pjesëmarrësve në protestë, pavarësisht prej sinjaleve se mund të ketë reagim të vrazhdë nga policia.

Për analisten politike Liliya Shevtsova reagimi më shumë se gjithçka është një sinjal se ku janë kufijtë për Kremlinin. Dhe këta kufij e kanë zanafillën në vendimet e liderit sovjetik Mikhail Gorbachev, në vitet 1980 dhe perceptimin se politikat e tij kanë çuar në prishjen e vendit. "Kremlini e kujton mirë epokën e Gorbaçovit: Hapeni dritaren pak dhe ata do ta hapin gjithë

derën", ka shkruar Shevtsova në një koment të publikuar në uebfaqen e radio-stacionit Ekho Moskvy.

Shifrat e pjesëmarrësve në protestat e fundjavës sillen nga 3 500 deri në 20 000, varësisht se kush i bën numërimet: zyrtarët apo grupet opozitare.

Një javë më herët, një protestë e ngjashme në Moskë ka mbledhur mbi 22 000 njerëz sipas organizatorëve dhe ka qenë më e madhja që nga vitet 2011-2012. Vladimir Gelman, i cili ligjëron në Universitetin Evropian në Shën Petersburg, ka thënë se pjesëmarrja ishte më e madhe sesa që prisnin autoritetet dhe se reagimi i ashpër ka qenë reflektim i faktit që janë zënë në befasi. Siç lë të kuptohet Shevtsova, çështja nuk është se kush do të garojë në zgjedhjet lokale në Moskë, apo nëse policia ka të drejtë t'i godasë njerëzit, apo nëse rusët kanë të drejtë të mblidhen paqësisht.

Pasiguritë që kanosen

Nuk është ende e sigurt nëse Putini do të përpiqet ta ruajë


autoritetin apo kush do ta pasojë nëse nuk e bën një gjë të tillë. Falë procesit koreografik zgjedhor dhe kontrollit të Kremlinit mbi mediet, Putini është zgjedhur me shumicë dërrmuese president në mars të vitit 2018. Por, popullariteti i tij është dëmtuar nga stagnimi i pagave, rritja e moshës së pensionimit, neveria me partinë Rusia e Bashkuar dhe pakënaqësitë me procesin politik, veçanërisht në nivelin lokal. Kjo e komplikon krijimin e një plani pasardhës ose të një plani të pas-Putinit. Imazhet e policisë, duke i bllokuar protestuesit që ushtronin një të drejtë të garantuar me kushtetutë, e bëjnë atë edhe më të ndërlikuar.

E ajo që i bën gjërat edhe më keq është se Navalny dhe grupe të tjera opozitare po arrijnë t'i përçojnë mesazhet e tyre, edhe pse Kremlini ua ka bllokuar qasjen në televizionin shtetëror.

Tatyana Stanovaya, analiste që drejton një organizatë këshilluese të quajtur R. Politik, ka thënë se përgjigjja e policisë gjatë fundjavës duket se sugjeron se Kremlini po humb përballë opozitës. "Kremlini duket se nuk e di çfarë të bëjë me opozitën anti-regjim, që ka kapacitet të organizojë protesta në rrugë", ka shkruar ajo në një koment të publikuar nga Qendra Carnegie në Moskë. "Shtypja e tanishme dhe një raund i ri i ndjekjeve penale të aktivistëve janë bast i qartë për një skenar më të ashpër", ka thënë Stanovaya.

Qeveria, sipas saj, është e hutuar dhe "një konfuzion i tillë brenda qeverisë është rezultat i faktit se nuk ka asnjë mënyrë të lehtë për të dalë nga kriza aktuale".

Rusia ka hyrë në një periudhë të pasigurisë serioze, ka thënë ajo. Grupet e opozitës po përpiqen të marrin mbështetje për një protestë tjetër në rrugë brenda një jave. Autoritetet, ndërkaq, po mbajnë seanca gjyqësore për disa prej të arrestuarve, kryesisht nën akuzat për kundërvajtje dhe shkelje administrative. (rfe).



Mumin Shakhrov (RFE/RL)

Presidenti Trump do ta vizitojë Poloninë

UASHINGTON, 30 KORRIK - Presidenti i Shteteve të Bashkuara, Donald Trump, do ta vizitojë Poloninë më 31 gusht deri më 2 shtator, për të marrë pjesë në ceremonitë e shënimit të 80-vjetorit të përfundimit të Luftës së Dytë Botërore, njoftoi kabineti i presidentit të Polonisë. Kjo do të

jetë vizita e dytë e presidentit Trump në Poloni, që nga korriku i vitit 2017. E udhëhequr nga një qeveri e krahut të djathtë, Polonia është ndër partneret më të afërta të Uashingtonit në Evropë. Bashkëpunimi midis dy vendeve bazohet në fushën e mbrojtjes dhe të energjisë.

Më 1 shtator presidenti Trump do të marrë pjesë në një ceremoni në Varshavë e cila shënon 80-vjetorin e pushtimit nazist të Polonisë, më 1 shtator 1939. Rreth 6 milionë qytetarë polakë u vranë gjatë luftës, gjysma e tyre hebrenj dhe vendi u shkatërrua tërësisht përgjatë viteve të luftës.





AUTOSHKOLLA "RITMO - L"

**Auto Shkolla
"RITMO - L"
Prishtinë**

**Eksperienca jonë
- përfitimi i juaj.**

**Ju mirëpret:
Stafi i Auto Shkollës " Ritmo -L "**

Tel / kontakt:

044 248 173

044 200 604

044 375 333

E jashtëzakonshme

Rekord botëror, Etiopia mbjell mbi 350 milionë pemë për një ditë

Etiopia ka shënuar një rekord të ri botëror duke mbjellë më shumë se 350 milionë pemë të reja brenda një dite. Fushata e titulluar "Trashëgimia e gjelbër" synon ripyllëzimin e vendit për t'i parandaluar katastrofat mjedisore që vijnë si pasojë e ndryshimeve klimatike dhe procesit të shkretëtirimit. Nismës së gjelbër të shpallur nga kryeministri i vendit, Abiu Ahmed, iu përgjigjën të hënën miliona qytetarë.



FOTO E DITES



Disa fëmijë shihen duke luajtur pranë një kompleksi apartamentesh në periferi të Yangonit në Myanmar. /AFP/

E rrallë

NASA zbulon një planet të ri të ngjashëm me tokën

NASA ka gjetur tre planetë të rinj, duke përfshirë një loj të botës së padukshme në sistemin tonë diellor. Planeti misterioz, i njohur si TOI-270, është një botë "lidhëse që mungon" dhe që mund të jetë një dhuratë e madhe për ata që i kërkojnë botët e tjera. Të tre planetët gjenden



rreth orbitës rreth një ylli që është vetëm 73 vit dritë larg prej nesh. Planeti i ri është pjesë e 'Disneylandit të vërtetë' për hulumtuesit që kërkojnë botën e huaj, thonë shkencëtarët.

BARSOLETA E DITËS



Ishin dy shokë dhe po flinin gjumë. Secili ishte i shtrirë në krevatin e vet. Natën ngrihet njëri dhe i thotë tjetrit:
 - Zgjuar je apo ke fjetur?
 - Pse?, i përgjigjet tjetri.
 - Sepse më duhen 10 000 euro.
 - Jam duke fjetur, ia kthen shoku.




Programi i shfaqjes së filmave në Kino ABC

Çdo ditë në ora 15:30
"Spider-Man Far From Home" 3D,

Aksion/Aventurë/Komedi; 2 orë 09 min
 Rolet: Tom Holland, Samuel L. Jackson, Zendaya, Cobie Smulders, Jon Favreau, JB Smoove, Jacob Batalon, Martin Starr, Marisa Tomei, Jake Gyllenhaal

Regjia: Jon Watts



Çdo ditë në ora 17:30

"THE LION KING" 3D

Aventurë/Dramë; 1 orë 58 min

Rolet: Donald Glover, Seth Rogen, Chiwetel Ejiofor, Beyoncé Knowles-Carter, James Earl Jones, Alfre Woodard, John Oliver

Regjia: Jon Favreau



Në ora 19:30 dhe 22:00

"HOBBS & SHAW"

Aksion/Aventurë/Triller; 2 orë 15 min

Rolet: Dwayne Johnson, Jason Statham, Idris Elba, Vanessa Kirby, Helen Mirren, etj.
 Regjia: David Leitch




Nga dt. 08.08.2019

"THE ANGRY BIRDS MOVIE 2"

Horror/Triller; 1 orë 39 min

Rolet: Jason Sudeikis, Josh Gad, Leslie Jones, Bill Hader, Rachel Bloom, Danny McBride, Peter Dinklage, Nicki Minaj

Regjia: Thurop Van Orman



Për informata dhe rezervime të biletave thirrni **FALAS: 0800 22 222** dhe boxoffice@kinoabc.info, www.kinoabc.info, fb: Kino ABC.

 <p>DASHI Disa</p> <p>ndryshime të fundit mund ta bëjnë ditën tuaj më interesante. Gjërat që do të vijnë do të jenë pasojë e ndryshimeve.</p>	 <p>DEMI Ndjeni që disa iniciativa tuaja janë bllokuar dhe nuk po dini si të veproni. Duke shmangur debatet thjesht do ta lini punën tuaj të papërfunduar.</p>	 <p>BINJAKËT</p> <p>Po luani rolin e viktimës kur në të vërtetë ju nuk jeni të tillë. Mundohuni të hiqni dorë sa më shpejt nga kjo sjellje.</p>	 <p>GAFOR-RJA Jeni rationale</p> <p>sot në ato që ndodhin dhe e kuptoni që jo gjithmonë njerëzit tuaj të afërt kanë të drejtë.</p>	 <p>LUANI Dita e sotme është e ndarë në dy pjesë, mëngjesi ju gjen sa më praktik dhe me këmbë në tokë, ndërsa mbrëmja është euforike.</p>	 <p>VIRGJËRESHA Keni qejf të rini në shoqëri të mirë sot dhe në mbrëmje mbase të diini. Ju mungojnë ditët e</p>
 <p>PESHOR-JA</p> <p>Mendoni se sot jeni zgjuar pa asnjë interes dhe disi të plogësht. Me</p>	 <p>fillimin e ditës do të shikoni që gjithçka do të ndryshojë.</p> <p>AKREPI Sot ndiheni vetëm dhe</p>	 <p>kjo gjë po ju rëndon</p> <p>psikologjikisht. Do të donit të kishit pranë një mik të mirë, por do ta keni të vështirë ta gjeni.</p>	 <p>SHIGJETARI Një zhvillim i papritur sot premtori ndryshime radikale në jetën tuaj. Duhet të merrni vendime që kanë të</p>	 <p>bëjnë me të ardhmen tuaj.</p> <p>BRICJAPI Të gjithë vëmendjen tuaj sot do ta marrë mbrëmja. Po përgatiteni për një</p>	 <p>festë mes miqsh ku siguri do të jeni protagonist.</p> <p>UJORI Sot, për siguri, po qën-</p>

Jenniferi befason Alex Rodriguezin me një tortë edhe një ditë pas ditëlindjes



Muaji i ditëlindjeve po vazhdon për Jennifer Lopezin dhe Alex Rodriguezin. Të dielën këngëtarja, e cila mbushi 50 vjet javën e kaluar, surprizoi Rodriguezin gjatë ndeshjes së Yankees dhe Red Sox në

Boston, një ditë pasi ish-sportisti mbushi 44 vjet. J Lo ia dërgoi tortën e shoqëruar nga dy vajzat e Rodriguezit, Ella dhe Natasha. "E gjithë vera ishte një tortë e madhe", iu tha Rodriguezi kolegëve të tij Jessica Mendoza dhe Matt Vasgersian.

Kim Kardashian tregon se si i fsheh djegiet e diellit



Kim Kardashian vazhdon të jetë e përfolur çdoherë. Bukuroshja, e cila fiton milionat nga produktet e kozmetikës, së fundmi u ka treguar fansave se si t'i mbulojë të djegurat e diellit me makijazh.

Nëpërmjet një video në "Instagram" Kim shfaq pjesën e gjoksit para dhe pas grimit. "Djegje të diellit, nuk më ka ndodhur me vite por, faleminderit Zotit! E bëra trupin me makijazh javën e kaluar", ka shkruar Kimi.

back with
@showstarboxer after
the LONGEST TIME



Dua Lipa bëhet 'boksierë'

Dua Lipa adhurohet nga miliona njerëz për zërin dhe projektet që sjellë, e si shpërblim për këtë këngëtarja shqiptare e njohur botërisht është mjaft aktive në rrjetet sociale duke ndarë pjesë nga përditshmëria e vet me fansat. Në postimin e

bërë në "Instastory" këngëtarja shihet se ka filluar javën në mënyrë të shëndetshme, Dua po e praktikon sportin e boksit. Kujtojmë se në fund të kësaj jave fillon 'Sunny Hill Festival', ku këtë edicion Dua pritet të jetë e pranishme vetëm si një mysafire.

Motrat Hadid shkaktojnë "tërmet"



Dy supermodelet e tashme janë në Mykonos, Greqi, duke festuar ditëlindjen e 34 të Alana Hadidit. Bella, 22 vjeç, dhe

Gigi Hadid, 24, u panë të hënën në super formë. Ato shkëlqenin në bikini dhe duket se po shijonin në maksimum kohën e pushimit.



Autor: GAZMEND MORINA	AKTORJA ITALIANE NË FOTO (shqip.)	MBARIMI I BOTËS (pashq.)	MË VJEN GJUMË E MË VARET KOKA DUKE NDENJUR	AMPER, JEMEN, ELEKTRON	RRALLË (lat.)	ZANORE	SUDOKU								
MEKANIZËM QË SHËRMBEN PËR TË LEHTËSUAR NGRITJEN E PESHAVE TË RËNDA	<input type="radio"/>						7				1	4		3	
KRAHINË NË KOSOVË	<input type="radio"/>					I ÇELE		1		2			9	7	
ZYRË NDIHME JURIDIKE QË MERRT ME VEPRIMET NOTERIALE	<input type="radio"/>						2		8						
MARKË E VESHJEVE SPORTIVE (origj.)	<input type="radio"/>						9	3	1		8				
FURRË KU PIQEN TULLA	<input type="radio"/>							4				1			
AKTORI HOLLIVUDIAN .. PAÇINO	<input type="radio"/>			ZË ME DORË QË NUK I PËRKET FESË DHE KLERIT				7	5	2	9		8		
DYPALËSH	<input type="radio"/>										6		4	5	
	<input type="radio"/>						5	6			3		7		
	<input type="radio"/>						3		2	9					
							CEREMONITË FETARE								
							MJET PUNE								
							LIRIDON (perkdh.)								
							EPOKA ERE							LUMË NË KOSOVË	
														BASHKËT. SPIKERJA MURTEZI - SHALA	

EPOKA ERE	KANAT	PROVINCË NË ITALI	ZANORE	EPOKA ERE	QYTET MË GJERMANI (pashq.)	PARA TË DYTËS "I" NË MES TË DY "E"				PARAARDHËSI YNË IKANAK				
BISHT I FRUTIT TË DISA PEMËVE E PERIMEVE				NJËRI NGA KATËR SHTETET QË FORMOJNË MBRETERINË E BASHKUAR ZANORE										
VARIOLË			SHKRIMTARI ALI LLOJ KROKODILI				DISIPLINË SPORTIVE AKTORJA ITALIANE ROSELLINI (shqip.)					BRITMË E LOPËS AUTOMJETI		
SOLISTJA QAZIMI			DUELI I BOKS GRIMCOVA (bised.)				SHTET (huaj) PUNËTORI TEATRIT TË KUKULLAVE					PJESË E TULTË E TRUPIT KRYEQYTETI I FILIPINEVE		
KËNGËTARE E JONA				ZANORE	I TAKON BURRË I GUXIMSHËM						AJKA E QUMËSHIT DAULLJA			
							KËNGËTARE E VJETËR SHQIPTARE UNIVERSITY LIMERICK ORCHESTRA							NJË PLANET
MASA NDËSHKIMORE (sh.shq.) SHIU I IMËT				LLOJ GURI I ÇMUESHËM BASHKËT.						FUTBOLLISTI ANGLEZ UEJN (MAN. UTD.) BASHKËT.				ZANORE TRAJNERI YNË VOKRRI
EPOKA ERE	KOMANDANT I NJË ANIJEJE	ZANORE QË ËSHTË LËNË I LIRË, PA FRE		MËDYSHJET FAZA							FUTBOLLISTI STIVEN (EVERTON) AFTËSI E PAGIMIT (treg.)			
SUPER MODELJA AMERIKANE UPTON (orgj.)				LLOJ PEME (sh.shq.) SIGURIM I GJËRAVE TË NEVOJSHME PËR JETESË							POEMË E VOGËL (shq.) MODELJA KRASNIQI			
NITROGJENI					SHPIRTI (Lat.)	AGIM TEJECI ARTAN (perkadh.)			HAPËSIRË E CAKTUAR TERRITORIALE (shq.) BASHKËT.				INDIUM FUTBOLLISTI ITALIAN IGNAZIO (MILAN)	
PARAKALIM USHTARAK (sh.shq.)							SHTET NË AZI ISH FUTBOLLISTI KROAT TUDOR					ALUMIN PËRKULJE NË NJËRËN ANË		KRYEQYTETI I PERUSË
IGLI TARE			EKSPOZITË E MADHE AKTORJA & MODELJA ANGLEZE ... HURLEY						NAIM ISMAJLI TRUP GJEOMETRIK			AZEM BEJTA MENDIM		BASHKËT. RINOR (perkadh.)
BASHKËT.		GABZHERR, GURMAZ PAMELA ANDERSON												
EPOSI				ERMELINDA MEKSI ZANORE			TRAJNERI GJERMAN REHAGEL BASHKËT.							BOTIM
OJNA					MBRET ILIR									PËRSHËND-ETJE ALLATURKA

ZGJIDHJA E FJALËKRYQIT: MAKARA, OPOJA, NOTERI, NIKE, H. KAMINIA, AL. KAP, BILATERAL, M. E PARA, ILIRI, FRE, UELLSI, LITERAR, LI, ALIU, KRKET, MU, EMA, MËCI, ETAT, MISH, GILI, I ZATËT, MAZA, DËNIMET, ANITA TAKE, RIGA, RUBIN, RUMI, U. A. DILEMAT PINAR, KATE, MOLLAT BALADA, AZOTI, AT ZONA, IN, PARADAT OMANI, AL, IT, PANAIR, NI, AB, L, T, LARING, KATINARI, EPI, EM, OTO, EDITIM, NAZE, AGRON, TEMENA. ZGJIDHJA E SUDOKU: Kolona 1: 785 691 423; KII: 416 325 897; KIII: 239 874 516; KIV: 923 168 754; KV: 854 739 162; KVI: 671 542 938; KVII: 197 286 345; KVIII: 568 413 279; KIX: 342 957 681.

'Mbreti' i verës, përfitimet e jashtëzakonshme shëndetësore të pjeprit

Pjepri është një frut shumë i përhapur dhe shumë i pëlqyer nga të gjithë. Ky frut mund të përdoret si shtesë e sallatave, ëmbëlsirave apo në formë të supës.

Këto janë disa nga benefitet më të rëndësishme shëndetësore, që pjepri ka:

Pjepri përmban një numër të madh të vlerave ushqyese- Pjepri përmban një numër të madh të përbërësve ushqyës. Ata përmbajnë 0 yndyrë, përmbajnë shumë pak kalori, vitaminë C, vitaminë B si dhe magnez.

Stabilizon shtypjen e gjakut- Në përgjithësi shumë fruta dhe perime kanë aftësi të përmirësojnë shtypjen e gjakut.

Përmirësojnë shëndetin e eshtrave- Pjepri ka disa përbërës

ushqyës, që kanë rol në mirëqenien e eshtrave. Prania e vitaminës K dhe magnezit në pjepër ju siguron eshtrave fortësi.

Përmbajnë sasi të lartë të ujit dhe elektroliteve- Nëse dëshironi të mbani trupin të hidratuar, gjëja e parë që ju bie në mend është të pini ujë. Mirëpo edhe frutat siç është rasti me pjeprin kanë një sasi të lartë të ujit dhe ju mbajnë të hidratuar.

Pastron lëkurën- Ngrënia e pjeprit mund të përmirësojë shëndetin dhe pamjen e lëkurës, për shkak se përmban një sasi të lartë të vitaminës C.

Forcon sistemin imun- Vitamina C është e njohur për përmirësimin dhe forcimin e sistemit imunitar. Shumë hulumtime, kanë treguar se vitamina C mund të parandalojë infeksionet dhe inflamacionet.



Përmirëson tretjen- Pjepri përmban fibra dhe përbërës të tjerë, që ndihmojnë në përmirësimin e funksionit të sistemit

tretës.

Përmirëson shikimin- Pjepri përmban dy antioksidantë shumë të rëndësishëm siç janë: luteina

dhe zeaksantina. Këto dy antioksidantë përmirësojnë shëndetin e syve dhe parandalojnë zhvillimin e sëmundjeve të syrit.

300 gra dhe vajza, 2 vjet në udhëtim për të pastruar oqeanet nga mbetjet plastike

Më shumë se 300 gra e vajza do ti bashkohen një udhëtimi mbarë botëror i cili pritet të nisë në muajin tetor me qëllimin që të nxjerrin në pah ndotjen shkatërruese të plastikës nëpër oqeanë si dhe të kryejnë hulumtime shkencore për krizën përshkallëzuese.

Miliona ton plastikë, duke nisur nga ambalazhet e ushqimeve në fibrat e veshjeve apo pajisjet e peshkimit, hyjnë në det çdo vit. Sipas ekspertëve detarë në vitin 2050 mund të ketë më shumë plastikë se peshq. Udhëtimi 2 vjetor, do të organizohet nga organizata jofitimprurëse eXXpedition e fokusuar në ndotjen detare. Lundrimi detar prej 38000 mil-jesh do të përfshijë Arktikun, ishujt Galapagos, ishujt e Paqësorit jugor dhe zonat përreth oqeanit qëndror ku grumbullohet plastika.

"Ajo që më bën shumë përshtypje është fakti se edhe pse jemi 1000 milje larg qenieve njerëzore,

sërisht e gjejmë një pastë dhëmbësh bosh," u shpreh drejtuesja e misionit Emily Penn për Thomson Reuters Foundation.

Ajo shtoi gjithashtu se 8 milion ton plastikë përfundojnë çdo vit në det, atje ku ndahen në copëza të vogla me përmasa të njëjta të një planktoni.

Këto copëza të vogla mund të gëlltiten nga gjallesat që jetojnë në këto ujra, duke dëmtuar rëndë ekosistemin dhe zinxhirin ushqimor.

Gratë nga fusha të ndryshme si shkencat, mësimdhënia, kinematografia, dizajni, fotografia, atletika etj do ti bashkohen anijes S.V. TravelEdge që do të nisë lundrimin më 7 tetor. Gjatë lundrim-



it ato do të bëjnë ndalesa, nga ku do të flasin me nxënësit apo komunitetin, apo të bëjnë pastrime. "Nuk është diçka që zgjidhet me shtypjen e një butoni. Ne na duhet të punojmë në çdo sektor, në çdo kënd," tha Penn.

"Ne kemi nevojë për material të reja, të ndryshojmë politikat, edukimin, na duhet të ndryshojmë mendësitë, kemi nevojë për inxhinierë. E vetmja mënyrë që mund ta zgjidhim është duke punuar të gjithë së bashku."

EURO GLASS
SAINT-GOBAIN
SEKURIT PILKINGTON
Enveri

Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE

"BUJQËSIA"

TEL: 045/82 82 82

E premtja e madhe e Ferizajt, Bylbyl Sokoli nuk e pret

Dita e premtë më 2 gusht pritet të jetë e madhe për klubin e Ferizajt pasi do të përmbillet çështja e privatizimit të klubit, por këtë ditë nuk e ka pritur trajneri Bylbyl Sokoli, i cili ka vendosur ta braktisë klubin që e shpëtoi nga rënia në Ligën e Parë. "Falënderim për një bashkëpunim të derisotëm. I dëshiroj suksese të gjithëmbarshme Ferizajt", ka thënë Bylbyl Sokoli

**EPOKA E RE**

Veton ZYMBERI

PRISHTINË, 30 KORRIK - KF Ferizaj me shumë bujë bëri publik lajmin për privatizim më 7 korrik, madje kryetari i Komunës së Ferizajt, Agim Aliu, u shpreh i kënaqur që klubi po privatizohet dhe se tani është një mundësi më e madhe që Ferizaj të luajë në Evropë, por problemet duken të paeliminueshme për këtë klub që vitet e fundit luftoi për mbijetesë e herë për inkuadrim në Superligë.

Ferizaj transferoi shumë lojtarë me emër në futbollin e Kosovës si Taulant Dajaku, Përparim Livoreka, Fisnik Papuqi, Fatih Karahoda, Ergon Hyseni, Dardan Jashari dhe Filonit Shaqiri, por asnjëri prej tyre ende nuk është prezantuar nga klubi në fjalë. Gazeta ka kontaktuar njërin nga futbollistët që është duke stërvitur me Ferizajn, por i njëjti ende nuk është i sigurt se a do të jetë pjesë e

kësaj skuadre. "Kam arritur marrëveshje me Ferizaj, por ende nuk kemi nënshkruar kontratë. Në Kosovë çdo gjë është e mundur dhe ekziston mundësia që mos të jem pjesë e këtij klubi në fillim të kampionatit", ka thënë futbollisti që nuk deshi që emri t'i përmendet në gazetë.

Ndërsa Klubi i Ferizajt në faqen zyrtare në "Facebook" ka njoftuar se të premtën do të përmbillet procesi i privatizimit dhe do të nënshkruhen kontratat me futbollistët. "Ditën e premtë do të jenë në Ferizaj aksionarët anglezë, ku pritet të finalizohen të gjitha çështjet e hapura për ta përmblyllur procesin e privatizimit, me ç'rast do të kemi edhe nënshkrimet zyrtare të kontratave me futbollistët, të cilët do të jenë pjesë ekipit tonë. Stërvitjet po vazhdojnë me intensitet dhe pritet që pas ditës së premtë do të merret edhe vendimi për shkuarje në turneun përgatitor jashtë vendit", thuhet në njoftimin e KF Ferizaj.

Mirëpo të premtën e 2 gushtit nuk do ta presë trajneri Bylbyl Sokoli, i cili në orët e vona të ditës së hënë konfirmoi largimin nga Ferizaj. "Profa" ishte më meritori për arritjen e mbetjes në IPKO Superligë, por duket se ai nuk ka gjetur gjuhë të përbashkët me drejtuesit e klubit. "Nuk do të jem më pjesë e KF Ferizaj. Një falënderim për 'Ujqit', për simpatizantët, qytetarët dhe të gjithë ata që e përkrahin KF Ferizaj, ngado që vijnë, brenda dhe jashtë Kosovës. Një falënderim për Bordin (Kryesinë) e KF Ferizaj në krye me Mustafë Graincan. Falënderim për drejtorin Nadir Haxhimusa, shtabin teknik, ndihmëstrajnerët, fizioterapeutët si dhe sekretarin e klubit. Falënderim futbollistëve të KF Ferizaj për angazhimin e tyre dhe arritjen e synimit për qëndrim në Superligën e Kosovës. Falënderim për një bashkëpunim të derisotëm, duke i dëshiruar suksese të gjithëmbarshme e suksese të reja Ferizajt", ka thënë Bylbyl Sokoli.

Feronikeli eliminohet nga Liga e Evropës

Ka marrë fund ëndrra evropiane e kampionit të Kosovës, Feronikeli, për sezonin 2019/20. Skuadra nga Drenasi është eliminuar nga Slovan Bratislava në rrethin e dytë kualifikues për Ligën e Evropës.

De Marco dhe Holam shënuan në "Fadil Vokri" të martën për t'ia dhënë fitoren Slovanit 0 me 2. Sllovakët fituan edhe ndeshjen e parë dhe në rrethin e ardhshëm kualifikohen me rezultat të përgjithshëm 4 me 1.



SHKURT

Osmani prezantohet te Llapi

Sulmuesi Labinot Osmani javë më parë kishte arritur marrëveshje me skuadrën e Llapit, por prezantimi është bërë sot nga skuadra "bardhekaltër". "Sulmuesi vushtrrias, Labinot Osmani, i mirënjohur për publikun llapjan, edhe zyrtarisht është pjesë e Llapit, pasi gjatë ditës së sotme ka nënshkruar kontratë njëvjeçare me klubin", thuhet në njoftimin e Llapit. "Labi" në të kaluarën ka luajtur për skuadrat e Hysit, Prishtinës, Feronikelit dhe, së fundmi, Vushtrrisë, me të cilën u inkuadrua në Superligë dhe arriti shifrën e 20 golave dhe 10 asistimeve.

Jure Gunjina përforcon KB Rahoveci

Alo-qendra kroate Jure Gunjina (204 cm) është përforcimi i parë i huaj te skuadra e Rahovecit për edicionin e ri 2019/2020. "Kroati Jure, 27 vjeçar, 204 cm i gjatë, luan në pozitën 3-4. Ai ishte pjesë e disa ligave të mëdha, në mesin e tyre edhe në Newcastle të Britanisë së Madhe, ndërsa në edicion e fundit ishte i angazhuar në një nga skuadrat top në Islandë", thuhet në njoftimin e KB Rahoveci.

Rahoveci është nënkampion i Kosovës dhe edicionin e ardhshëm do të debutojë në FIBA Europe Cup dhe Ligën Ballkanike. Në FIBA Europe Cup do të luajë në raundin eliminator, ku do të përballlet me Cluj Napocan nga Rumania.

Magani nuk largohet nga Kosova, prezantohet te Ballkani

Sulmuesi nga Shqipëria, Artur Magani, nuk është larguar nga futbollin e Kosovës. Sulmuesi që ka luajtur për Lirinë e Prizrenit dhe Feronikelin nga Drenasi është përforcimi i radhës për skuadrën e Ballkanit nga Suhareka. "Në përpjekje të vazhdueshme për konsolidim të skuadrës, në veçanti të sulmit para pak çastesh FC Ballkani ka arritur marrëveshje njëvjeçare me futbollistin këmbëshpejtë Artur Magani. Arturi është formuar si futbollist në shtetin amë, duke mbrojtur ngjyrat e ekipeve si KF Teuta, KF Shkumbini, ndërsa Superligën e ka shijuar me fqinjët nga Prizreni, FC Liria dhe, së fundmi, te kampioni i Kosovës, KF Feronikeli", thuhet në njoftimin e Ballkanit.

Morina lë Zvicrën për Kosovën

Sami Morina ka vendosur ta përfaqësojë Kosovën në sportin e triatlonit. Morina, që deri më tani ka marrë pjesë në gara të ndryshme në shtetin zviceran, tani e tutje do ta përfaqësojë Kosovën në gara ndërkombëtare. Federata e Triatlonit të Kosovës është formuar muaj më parë. Morina, i cili ndodhet në Kosovë, e ka vizituar Komitetin Olimpik të Kosovës, ku është pritë nga kryetari Besim Hasani dhe nënkryetari Gazmend Maxhuni. Hasani përgëzoi Morinën për vendimin e marrë, duke i uruar suksese në garat ndërkombëtare. Vetë Morina shprehi optimizëm se do të garojë për ta fituar normën olimpikë "Tokio 2020", për çka kryetari Hasani shprehu gatishmërinë për hulumtimin e mundësive për ta ndihmuar.

Mourinho: Më mungon futbollli

Setubal, 30 korrik - Trajneri Jose Mourinho ka pranuar se po i mungon futbollli dhe se është i gatshëm për të drejtuar një skuadër. Ish-trajneri i Real Madridit dhe Chelsea u shkarkua nga Manchester Unitedi më 18 dhjetor të vitit të

kaluar, kurse ende vazhdon të jetë i paangazhuar në ndonjë skuadër. "Kjo është në të vërtetë hera e parë që kam kohë për të menduar, hera e parë që jam në Setubal në fund të korrikut ose në fillim të gushtit në më shumë se 20 vjet. Kam ca kohë që të

mendoj, të rimendoj, të analizoj dhe ajo që ndiej është saktësisht se 'Ze' (pseudonimi i Mourinhos si fëmijë) është plot zjarr! Të gjithë më thonë të shijojë këtë kohë, por sinqerisht nuk po mund ta bëj një gjë të tillë", ka thënë Mourinho për "Sky Sports

News". "Më mungon futbollli, kam një kompromis me veten time, me njerëz që më duan, me aq shumë tifozë që kam në të gjithë botën, aq shumë njerëz sa kam frymëzuar. Jam i gatshëm të rikthehem", ka deklaruar Mourinho.



Martinaj: Kemi nevojë për përkrahjen e tifozëve

PRISHTINË, 30 KORRIK - Nga 3 deri më 11 gusht Prishtina do të jetë arenë e ndeshjeve të Kampionatit Evropian, Divizioni B, për femrat U20. Për tetë ditë me radhë, 12 kombëtare do të zhvillojnë shumë ndeshje interesante, derisa për herë të parë vashat e Kosovës U20 marrin pjesë në një garë të nivelit të tillë. Vashat e Kosovës debutojnë në shtëpi dhe kërkojnë përkrahje nga publiku.

Kapitenia e Kosovës U20, Besjana Martinaj, ka folur për përgatitjet e deritashme. "Jemi në ditët e fundit të përgatitjeve për këtë evropian. Kemi stërvitur dy herë në ditë dhe do të përpqemi ta përfaqësojmë sa më mirë vendin në këtë evropian", ka thënë Martinaj për faqen zyrtare të FBK-së. Ajo ka folur edhe për rëndësinë që ka publiku për lojtarët në fushë. "Ne me Kosovën U20 për herë të parë po marrim pjesë në një ngjarje kaq madhore. Gjithashtu, jemi vajza më të reja se kundërshtarët, andaj kemi nevojë për përkrahjen e publikut. Ne do të përpqemi të fitojmë përvojë nga ky evropian dhe të japim më të



mirën në fushë", ka shtuar ajo. Vashat e Kosovës janë në grup me Turqinë dhe Rumaninë. "Do të mundohemi të bëjmë paraqitje të mira, sepse kundërshtarët janë shumë të forta dhe kanë më shumë përvojë se ne. Për ne ka rëndësi edhe ndihma e publikut

në këso përballje, andaj i ftoj të gjithë të na përkrahin, derisa ne do ta japim maksimumin me forcat tona", ka përfunduar Martinaj. Sfidat e parë e Kosovës do të jetë ndaj Turqisë më 3 gusht, pas ceremonisë hapëse, kurse takimi tjetër ndaj Rumanisë më 5 gusht.

Ronaldo: Nuk ndikova në transferimin e De Ligt, Neymarit qëndron në Paris

MADRID, 30 KORRIK - Cristiano Ronaldo ka dhënë një intervistë të gjatë për gazetën spanjolle "MARCA". Ylli portugez u vlerësua nga media e njohur me çmimin "legjenda" për ndër të arritjeve të shumta të 34-vjeçarit në botën e futbollit. I pyetur se a ka qenë ai vendimtar në transferimin e De Ligt, Ronaldo është përgjigjur: "Jo, nuk e besoj. Më vjen mirë që ma bëjnë këtë pyetje. Në finalen e Ligës së Kombeve bëjmë një bisedë, që është diçka normale që e bëjnë të gjithë futbollistët. Ajo duhet të qëndronte mes nesh në fushë, por ai është 19 vjeç dhe e tha thjesht si një shaka. Gjithsesi, unë kurrë s'kam dhe s'do ta influencoj trajnerin ose drejtuesit për merkaton. Megjithatë, e vërteta është se jam shumë i gëzuar që ai është pjesë e jona tani". Ylli portugez foli edhe për transferimin e mundshëm të Neymarit në Barcelonë. Sipas tij, kjo nuk do të ndodhë dhe se ai do të mbetet pjesë e PSG-së. "Nuk e di ç'do të ndodhë. Është



një lojtar i madh me të cilin kam raporte shumë të mira. Flitet shumë për të, sikur e kërkon Reali, Barcelona dhe Juventus, por unë mendoj se këto janë thjesht fjalë mediatike. Është e kuptueshme pasi emri i Neymarit shet shumë.

Unë mendoj se ai do të qëndroj në Paris. S'po kalon një çast të mirë, por nëse nuk dëmtohet më jam i sigurt se do t'i rikthehet gëzimi. Dëshiroj që të luajë sa më shumë, pasi ka kaluar kohë të këqija", ka deklaruar Ronaldo.

SHKURT

Donadoni, trajner i Shenzhenit

Pas një viti pushim, Roberto Donadoni i rikthehet punës si trajner dhe këtë herë e bën në Kinë, ku ka nënshkruar me skuadrën e Shenzhen FC. Lajmi është dhënë nga vetë klubi kinez në rrjetet sociale ku, ndër të tjera, thuhet se Donadoni ka mbërritur në Kinë dhe është gati ta fillojë aventurën, për ta zëvendësuar spanjollin Juan Caro. Donadoni, përveç Kombëtares së Italisë, i ka drejtuar edhe Livornon, Genoan, Napolin, Parmën, Cagliariar dhe Bolognan.

Boatengu, afër marrëveshjes me Fiorentinën

Kevin-Prince Boateng do të largohet nga skuadra e Sassuolos këtë verë, por jo nga Seria A. Siç raportojnë mediet italiane, mesfushori ganez ka gjetur akordin me Fiorentinën. Ekipi vjollcë është në kërkim të një mesfushori me përvojë dhe Boateng shihet si futbolli i duhur. Sezoni e shkuar Boa u rikthye në Serinë A duke nënshkruar për Sassuolon, por në janar u huazua te Barcelona, transferim që u konsiderua si më i çuditshmi i muajit janar. Pas gjashtë muajsh si katalanas, Boateng u rikthye te Sasuolo këtë verë, por duket se nuk do të qëndrojë gjatë. Bisedimet mes Sassuolos dhe Fiorentinës janë drejt fundit.

Mulleri provokon Dortmundin: Titulli nuk diskutohet

Sulmuesi i Bayern Munchen, Thomas Muller, ka provokuar kundërshtarët e Borussia Dortmundit në lidhje me konkurrencën për sezonin e ri. Ish-futbollisti i Gjermanisë mendon se konkurrenca i bën mirë kampionatit, por "bavarezët" do ta fitojnë sërish trofeun. "Parapërgatitjet e këtij sezoni janë jashtëzakonisht të mira, pasi është më shumë qejf kur duhet të përballësh me një kundërshtar të fortë dhe nuk e sheh veten gjithmonë si gur prove", ka thënë Muller. Ai nuk e diskuton titullin kampion, pavarësisht prej forcimit të Dortmundit, por dilema e vetme për të është nëse e arrijnë në mars apo prill. "Bayerni do të jetë kampion pa diskutim. Pyetja e vetme është nëse e fitojmë titullin në mars ose në prill. Është gjë e mirë që Dortmundi e ka shpallur objektivin për ta fituar titullin kampion", ka deklaruar Muller.

Problem tjetër për Realin, lëndohet Courtoisi

Shtohen problemet me lëndime në skuadrën e Realit të Madridit. Sapo kanë kaluar 20 ditë nga nisja e fazës përgatitore, por numri i lojtarëve të dëmtuar, pjesë e ekipit të parë, ka shkuar në pesë: Brahim, Mendy, Asensio, Joviq dhe, së fundmi, Thibaut Courtois. Sikurse konfirmoi klubi madrilen, portieri belg ka pësuar një dëmtim në kavigj (përdredhje) e për pasojë nuk do të jetë pjesë e skuadrës në Gjermani për Audi Cup. "Gardiani" i "Los Blancos" pritet të qëndrojë 1 muaj në infirmieri, që do të thotë se do ta humbasë edhe takimin e parë sezonal, atë të kampionatit në "Balaidos" me Celta Vigon.

Jean Todt: Me Schumacherin kam shikuar së fundi garat e Formulës 1

Michael Schumacher ka pësuar një aksident të rëndë gjashtë vjet më parë, e cila gjë kishte bërë të binte në gjendje kome. Për shëndetin e garuesit të Formulës 1 ka pasur informata kundërtëse gjer në ditën e sotme, ku ka folur ish-presidenti i Ferrarit, Jean Todt. Ky i fundit ka folur për mediat duke thënë se me pilotin gjerman ka shikuar disa gara të veturave të shpejta në shtëpinë e tij në shtetin zviceran. "Unë gjithmonë jam i kujdesshëm me deklaratatë të tilla, por është e vërtetë. Kam parë në garë së bashku me Michael Schumacher në shtëpinë e tij në Zvicër", ka thënë fillimisht francezi. "Michael është në duart e sigurta dhe shumë mirë po kujdesen në shtëpinë e tij. Ai nuk heq dorë dhe vazhdon të luftojë", ka shtuar ai. Kampioni i shtatëfishtë botëror i Formulës 1, i cili këtë vit ka mbushur 50 vjet, gjatë skijimit ka rrëshqitur dhe ka goditur kokën për një shkëmbi gjatë pushimeve në Alpet Franceze. Ndryshe, Todt është drejtuesi i Federatës së FIA-s dhe bën vizita të rregullta te Schumacheri në Zvicër.



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo
Qeveria – Vlada – Government
Ministria e Financave - Ministarstvo za Finansija - Ministry of Finance
Thesari i Kosovës - Trezor Kosova - Treasury of Kosova

Duke u bazuar në Ligjin nr. 03/L-149 Për Shërbimin Civil të Kosovës, Rregulloren nr. 02/2010 Për Procedurat e Rekrutimit në Shërbimin Civil të Republikës së Kosovës, si dhe nenin 4.2. të Ligjit Bazik 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Thesari në Ministrinë e Financave, publikon këtë:

KONKURS

Institucioni: Thesari i Kosovës – Ministria e Financave

Titulli i pozitës: Zyrtar për Menaxhimin e Borxheve

Divizioni: Menaxhimi i Borxheve / Zyra e Përparme

Numri i referencës: 20/2019/ TH- BF/1210

Kategoria Funktionale: Niveli profesional

Koeficienti: 7 / Grada 9

Lloji i pozitës: i Karrierës

Orari i Punës: 40 orë në javë (me orar te plote)

Kohëzgjatja e emërimit: nëpunësi i karrierës (pa afat te caktuar)

Periudha provuese : Dymbëdhjetë (12) muaj

Nëpunësi raporton te: Udhëheqësi i Divizionit të Borxheve

Vendi i punës: Prishtinë, Ndërtesa e Qeverisë së Republikës së Kosovës

Qëllimi i vendit të punës:

Realizimin e detyrave të parapara për pozitën përkatëse në funksion të menaxhimit efikas të Borxhit Publik të Kosovës.

Detyrat dhe Përgjegjësitë:

- Zhvillon komunikim dhe bashkëpunim profesional me palët bashkëpunëtorë të jashtëm;
- Në koordinim edhe me Njësinë përkatëse të Divizionit për Menaxhimin e Borxhit zhvillon analizat e riskut në portfolio për secilën kredi në procesin e negociimit;
- Përgatitë Kalendarin e emetimit të Letrave me Vlerë, kalendarët mujor dhe shpalljet e ankandeve sipas legjislacionit në fuqi;
- Përgatitë raporte analitike për tregun e brendshëm dhe tregjet e jashtme të Letrave me Vlerë;
- Përgatitë raporte të rregullta për Borxhin e Brendshëm;
- Mbështet aktivitetet e Divizionit për Menaxhimin e Borxhit për dizajnimin e Programit të Borxhit Shtetëror si dhe draftimin e strategjisë vjetore të emetimit të Letrave me Vlerë;
- Kryen edhe punë dhe detyra tjera në mbështetjen e Njësisë së Pasmë të Divizionit të borxheve për raporte dhe procedimin e pagesave për Borxhin e Brendshëm;
- Mirëmban dosjet elektronike dhe fizike për Borxhin Shtetëror;
- Kryen çdo detyrë tjetër në fushën profesionale specifike në përputhje me ligjet dhe rregulloret aktuale të cilat mund të kërkohen në mënyrë të arsyeshme kohë pas kohe për të siguruar menaxhim efektiv dhe efikas të Borxhit Shtetëror.

Kualifikimi dhe përvoja

- Diploma e universitetit në fushën e Ekonomisë;
- Përvojë profesionale - 2 vjeçare, pas diplomimit.

Shkathtësitë e kërkuara

- Njohuri të thellë në fushën profesionale specifike të fituar përmes arsimimit universitar;
- Njohuri të gjuhës Angleze, në të folur dhe të shkruar e obligueshme;
